



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

#### **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 10.7.2023, ora: 10:30

#### **Drejton mbledhjen:**

**Flutura Aça – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Seancë dëgjimore me anëtarë të Asamblesë së Akademisë së Shkencave për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin, nr.53/2019, datë 18.07.2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë", propozim i një grupi deputetësh.

2. Diskutimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin, nr.53/2019, datë 18.07.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, propozim i një grupi deputetësh.

#### **Marrin pjesë:**

Flutura Aça, Petro Koçi, Lindita Buxheli, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Ilir Topi, Ilir Metaj, Ina Zhupa, Andia Ulliri, Merita Bakiu, Eralda Bano, Kastriot Piroli, Oriola Nebijaj, Ismeti Beqiraj (zëvendësues) dhe Fadil Nasufi (zëvendësues).

#### **Mungojnë:**

Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi dhe Agron Gjekmarkaj.

#### **I ftuar:**

Artan Fuga - akademik.

## HAPET MBLEDHJA

**Flutura Aça** - Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Edukimin dhe Medien të datës 10 korrik siç e kemi lënë edhe sipas kalendarit, javën e shkuar.

Sot kemi seancën dëgjimore me anëtarë të Asamblesë së Akademisë së Shkencave për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin, nr.53/2019, datë 18.07.2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë", propozim i një grupi deputetësh.

Kanë qenë të ftuar anëtarët e Asamblesë së Akademisë së Shkencave dhe është prezent zoti Fuga, i cili ka bërë kërkesën e tij personale për t'u paraqitur për t'u dëgjuar në komision, në lidhje me çështjet që rezultojnë shqetësimet e tij, si akademik, në raport me ligjin, t'ia bëjë me dije komisionit dhe pastaj komisioni të vendosë dhe ta shqyrtojë pas dëgjesës së zotit Fuga.

Zoti Fuga, mirë se keni ardhur!

Biseda me ju nuk do të jetë në formën e debatit. Ju do të bëni shpjegimet tuaja. Deputetët kanë të drejtë të bëjnë pyetje që kanë lidhje me ligjin, qoftë edhe me Akademinë në përgjithësi. Nuk është e thënë të jenë në lidhje vetëm me këtë projektligj, por me Akademinë në përgjithësi, aq më shumë kur ju jeni pjesë e Asamblesë dhe pjesë e asaj Akademie. Të jem e sinqertë me ju, ne kemi kërkuar disa herë që zoti Gjinushi të paraqitet në komision, por e ka refuzuar, ka sjellë njerëz të tjerë që janë po aq të nderuar, dhe ky komision i ka dëgjuar me vëmendje, por e mira do të ishte, edhe për respekt të këtij komisioni, një njeri që është marrë gjithë jetën me politikë, ta kuptojë që parlamenti është i pari, pastaj vijnë sipas piramidës së pushtetit gjërat. Por është çështje e tij personale. Kjo nuk na ka penguar ta bëjmë punën, por do të donim që ai të ishte paraqitur. Jo vetëm këtë, por do të doja t'i bëja një vërejtje publike zotit Gjinushi, i cili nëpër televizione ka shpjeguar, shpesh në mënyrë edhe sarkastike duke, nuk po e them fyer, por edhe duke përmendur deputetë të caktuar. Në fund të fundit ne kemi obligim të japim argumentet tona për çfarëdo lloj kauze, por nuk mundemi kurrsesi të fyejmë deputetë lartë e poshtë nëpër televizionet shqiptare, sepse duam, nuk duam ne, deputeti është mbi çdo pushtet tjetër. E them këtë në mënyrën e një vërejtjeje shumë miqësore, që nuk mund të bëhen sarkazma me deputetin, kushdo qoftë ai, sepse e kanë zgjedhur të tjerë njerëz që mbajnë përgjegjësi për të dhe performancën e tij.

Atëherë, zoti Fuga, para se të kalojmë në pyetjet e kolegëve të mi, dhe aty do të mbarojë seanca me ju, fjala për ju për parashtrimin tuaj të hollësishëm.

Faleminderit!

Merrni kohën që ju nevojitet.

**Artan Fuga-** Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja dhe zotërinj deputetë, për këtë mundësi që më dhatë për të ardhur për të parashtruar ato mendime dhe sugjerime që kam për amendamentet e paraqitura në formën e një projektligji!

Do të më lejoni që t'i parashtroj para jush, duke ju falënderuar paraprakisht për durimin, por gjithsesi ju siguroj që kam kujdesin ta respektoj kohën tuaj me aq sa mundem.

Por nga ana tjetër them që rast i vetëm, është një rast unikal, që unë e konsideroj me shumë respekt, prandaj do të dëshiroja që, siç tha dhe zonja kryetare, t'i shteroj të gjitha ato ide me synimin e mirë të kemi një ligj bashkëkohor, koherent për Akademinë e Shkencave, sikurse besoj se është dëshira e të gjithëve neve që jemi këtu.

Pasi ju falënderoj edhe një herë për këtë mundësi që m'u dha, desha të them fillimisht se nga vjen motivi im. Ç' motiv kam unë që, sikurse e dini, kam insistuar ndonjëherë për të arritur atë të drejtë që unë mendoj se e ka çdo anëtar i Akademisë, kam insistuar ndonjëherë edhe me një këmbëngulje që të them të drejtën nuk më karakterizon.

Motivi im i parë është se për mendimin tim Akademia e Shkencave më këto 50 vjet nuk e ka gjetur dot vendin që duhet. Deri në vitin 1990 kuptohet që akademizmi shqiptar me të gjithë ata korifenj të shkencës sigurisht vuante nga ajo që ne e dimë të gjithë një presion ideologjik, politik, ndonjëherë sigurisht edhe presion policor, që ka rënë mbi shkencëtarë dhe dijetarë, të cilët Akademinë e tyre të Shkencave e kishin ndoshta dhe në kampe ndëshkimi, për fat të keq edhe në qeli burgu. Sigurisht nuk jam unë që flas për këtë dhe që më takon të flas, por e kam fjalën që edhe pas viteve '90 Akademia e Shkencave deri më sot në gjykimin tim nuk e ka gjeture vendin që ajo duhet të ketë për mendimin tim në sistemin e kërkimit shkencor të vendit.

Aktualisht, për të mos u zgjatur, unë shpreh konstatimin tim dhe përpjekjet e mia për të dalë nga kjo gjendje dhe jo për ta përkeqësuar këtë gjendje, sepse unë shoh aktualisht që Akademia e Shkencave pak a shumë luhetatet vërtitet rreth 3 funksioneve, të cilat nuk janë ato që duhet.

Së pari, ka rolin dhe do të marrë rolin e një agjencie tutele mbi Institutin e Albanologjisë. Po, nuk kam një ligj të ma shpjegojë për të thënë se ky ligj është apo nuk është në përputhje me ligjet e tjera për shkencën.

Së dyti, ka marrë pak rolin si do ta shohim më poshtë të një instituti kërkimesh pa pasur mjetet dhe njerëzit për të përballuar fusha heteroklite kërkimesh që fillojnë nga, sizmologjia, nga teknologjia, gjuhësia historia dhe të them të drejtën unë nuk njoh në botë ndonjë institut kërkimesh shkencore të jetë ndërtuar në këtë mënyrë ku të mos ketë një koherencë fushe. Pse ka ardhur kjo? Mbase është një bisedë tjetër e gjatë.

Së treti, ka marrë kuptimin e një agjencie që bën aktivitete shkencore ndihmëse siç mund t'i bënte një laborator, që nuk janë absolutisht të pavlefshme, por janë ndihmesë, një ceremoni, një konferencë, një debat, një përkujtim e të tjera.

Ta tria këto të them të drejtën nuk janë atë që ndoshta kombi, shoqëria, mjedisi universitar, intelektual do të kërkonte ndaj atij institucioni, ku edhe unë jam, ku edhe unë kam përgjegjësitë e mia, nuk e gjej nga jashtë, dhe përiqem normalisht, siç e kërkon etika e një njeriu që merret me shkencë, apo etika e një qytetari që të japë mendime të bëjë të gjitha përpjekjet që duhen.

Unë jam futur në Akademinë e Shkencave në vitin 2008, dhe kam ardhur nga sistemi universitar në Shqipëri dhe nga sistemi europian i kërkimit shkencor dhe i arsimit në Francë. Kam ardhur nga jashtë dhe të them të drejtën nganjëherë, kur shpjegohem me veten time, them fakti që kam ardhur nga jashtë më bën të kem një lloj lirie ndaj kësaj tradite, sepse unë nuk kam as meritën, por nuk kam as peshën e historisë së kaluar të Akademisë së Shkencave. Fillimisht e kam parë si dikush i jashtëm që vjen dhe pastaj, nga vetë përvoja dhe rrugëtimi im shkencor, duke kontribuar edhe në hapësirën europiane të kërkimit shkencor, e kam parë pak dhe me syrin e atyre e eksperiencave që unë jetoj.

Unë jam marrë me epistolmologjinë e shkencës, kam një diplomë në rang ekuivalentimi të profesorit në Francë për drejtimin e kërkimit shkencor në shkencat sociale dhe humane dhe jam marrë dhe me filozofinë e ligjit, e kam dhënë në mësimdhënien universitare shqiptare. Këto më bëjnë, kjo është referenca ime, që më duket mua, se më jep një lloj legjitimitimi sado modest për të thënë fjalën që mund ta them këtu para jush.

Në vitin 2019 kam kritikuar Kryesinë e Akademisë së Shkencave për rotacion fals. Nisur nga kjo pati një debat, pati një rimarrje dhe marrje të idesë nga politika, nga deputetët, nga shoqëria u bë një ligj. Dhe ajo që unë shoh është se ky rotacion fals të cilin unë e kam denoncuar i vetëm në vitin 2019 dhe që pastaj u legjitimua, ky denoncim mori forma ligjore, forma më të pjekura sigurisht, unë shikoj që kjo tendenca për mbajtje afatgjatë të pushtetit akademik praktikisht mund të shkojë deri në 12 vjet, sepse 4 vjet kanë kaluar dhe, nëse bëhet dhe këto amendamente hyjnë në

fuqi ka shumë mundësi, siç ka ndodhur herë të tjerë që të konsiderohet se që këtu fillon një etapë ku ligji hyn i ri i transformuar hyn në fuqi mund të shkojë edhe 12 vjet, 8-12 vjet pra. Të gjitha këto tendenca po na vijnë me një sfond paragjykimi, sikur nuk ka shumë rëndësi ripërtëritja e drejtimit në Akademi, por me anë të një ndërhyrje, që vjen nga deputetë të ndryshëm, të vihet në jetë ideja se për funksionimin e Akademisë së Shkencave politika ka besim vetëm te një njeri, që ka dalë nga politika, dhe ka krijuar dhe ka lidhje të drejtpërdrejta me politikën. Dhe ligjet ndryshohen herë pas here në funksion të këtij besimi që politika ka te një njeri, pa paragjykuar asnjë person.

Unë po jua them sinqerisht që unë pranoj më mirë që politika të vendosë dhe të thotë që Akademia e Shkencave është në gjendje të jashtëzakonshme dhe ne do të vendosim një njeri me një vullnet arbitrar, por do ta vendosim këtë njeri, se atje nuk ka njeri tjetër në formën e një që kemi njohur në histori të një komisarit të jashtëzakonshëm, do ta pranoja, apo ta komandojë dikë në Akademinë e Shkencave si një autoritet për ta nxjerrë nga kriza. Do ta pranoja me sinqeritet. Le ta bëjë hapur, sinqerisht, drejtpërdrejtë, më mirë se duke mbuluar me atë që quhet në gjuhën ligjore ndërkombëtare me batanije ligjore që, në fakt, e bën që ligji të marrë tërësi artificash për ta kontrolluar Akademinë e Shkencave sepse merren nëpër këmbë ligjet, merret nëpër këmbë akademiku, merret nëpër këmbë komuniteti shkencor i vendit.

Cili është objekti i shqyrtimit tim? Nuk po zgjatem. Objekti i shqyrtimit tim janë dy amendamentet e paraqitura nga zotërinjtë deputetë Petro Koçi dhe Ismet Beqiraj, në datën 9.01.2023, regjistruar me numër. protokoll 55.

Nuk po zgjatem këtu por dua të theksoj se unë nuk do të merrem me të gjithë përmbajtjen e amendamenteve, e amendamentit, por vetëm kam shqyrtuar dhe vërejtjet e mia janë për nenet 3 dhe të projektamendamenteve. Nenin 3, i cili kërkon të riformulohet neni 11 pika 4 të ligjit të Akademisë së Shkencave duke e ndryshuar krejtësisht atë që është sot dhe duke e paraqitur si bashkim i pikës 8 dhe 9 të këtij ligji. Ky propozim për ta riformuluar këtë nen deshoron të na japë një riformulim të ri sipas të cilit kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor, drejtuesit e seksioneve pra i gjithë ekipi drejtues në bllok, të rizgjidhen, të kenë mundësi të rizgjidhen në funksion për 2 mandate. Aktualisht është për dy mandate jo në vazhdimësi. Që do të thotë 2 mandate 4 kaluan edhe 8 bëjnë 12, po edhe sikur të mos jetë kështu, por praktika ka treguar që kështu është interpretuar, aktualisht që të kemi mundësinë e rimarrjes së mandateve. Dhe nenin 5 të projekt amendamenteve sipas të cilit anëtari i kryesisë e ndërpret mandatin nëse mbush moshën

75 vjeç. Kjo sipas amendamentit hiqet germa “c” e pikës 2 ndërsa germa “ç” bëhet “c”. Po nënteksti apo ajo që është e formuluar në përmbajtje është: mandati i anëtarit të kryesisë ndërpritet për një nga shkaqet e mëposhtme germa “c” mbush moshën 75 vjeç, kjo propozohet të hiqet. Jo sepse duke mos prekur pjesën tjetër që paraqitet në amendamente unë jam dakord me të, por, sepse mendoj se ajo kërkon një shqyrtim të hollësishëm. Në konceptin tim për Akademinë e Shkencave, ato shqetësime që ngrihen në këtë pjesë nuk janë të rëndësishme nuk janë prioritare, nuk është aty problemi, nuk janë ato që pengojnë veprimtarinë e Akademisë së Shkencave.

Dhe unë mendoj se ka tjetër gjë që është e ndjeshme. Unë ndalem në ato ndryshime që propozohen për mënyrën e ndërtimit të organeve drejtuese të Akademisë së Shkencave, sepse, më falni, për formulën që do të them ato janë bërë pas shpinës së akademikëve. Pra, është një projektamendament, i cili nuk ka asnjë gjurmë që të ketë ardhur si propozim i akademikëve. Kjo mua, ju them të drejtën, më shqetëson përse të ketë ndodhur kështu.

Cila është përqaqja e analizës sime? Unë nuk do të analizoj dhe nuk kam pranuar të kurrë të analizoj motive personale. Unë nuk sulmoj dhe nuk do të atakoj asnjëherë persona të veçantë. Brenda Akademisë, pavarësisht se ka deklarata ndaj meje të Kryesisë, ka ironira të Kryetarit, ka lloj-lloj insinuatash, nuk ka asnjë problem, unë nuk do të bëj këtë gjë. Unë po vij vetëm për të shqyrtuar as dobishmërinë e ligjit, por po vij për të treguar se sa është e mundshme kjo iniciativë për amendamente nga pikëpamja e legjislacionit nga pikëpamja ligjore.

Çfarë duhet të përmbajë për mua një ligj apo një projektligj? Më falni, ta them shpejt, sepse tregon universin tim të mendimit dhe ndofta do ta keni më kollaj që të kuptohemi. Ligji nuk mund të jetë logjikisht kundërthënës në vetvete, nuk mund të përmbajë nene që bien në kundërshtim me njëri-tjetrin. Ligji nuk mund të hyjë në konflikt me ligje të tjera që janë tashmë në fuqi. Ligji duhet të jetë në përputhje me frymën dhe nenet e Kushtetutës. Ligji duhet të respektojë procedurat në fuqi për ligjbërjen. Këto janë parime të cilat unë kam lektuar, unë atyre iu besoj, duke u nisur nga shkolla formaliste e së drejtës, nga shkolla neonatyrore e së drejtës. Dhe unë mendoj që këto parime nuk mund të votohen. Nuk është një çështje shumicë- pakicë mund të diskutosh shumicë pakicë për dobinë sociale apo institucionale, mund të diskutohen një sërë gjërash, po unë mendoj se nuk mund të votohen këto gjëra, nuk mund të votohet një e vërtetë institucionale e formuluar nga shkenca. Nëse ne do të fillojmë të votojmë për të vërtetat institucionale, pra të votojmë për të vërtetat unë mendoj që nuk është kjo rruga.

Cili është aksi qendror? Ku e kam mbështetur unë analizën time dhe qëndrimin tim kritik, kundër, rezistues ndaj këtyre amendamenteve? Unë kërkoj ndjesë ndaj zotërinjve deputetë Koçi dhe Beqiraj, por ata kanë bërë një gabim metodologjik. Ata kanë propozuar të ndryshohen dy nene të ligjit në fuqi për Akademinë e Shkencave duke mos mbajtur parasysh se duke ndërhyrë në pika të veçanta, në nene të veçanta, kanë lënë në harresë se ligji ka natyrë strukturore holistike që do të thotë se ato nene janë të lidhura në koherencë logjike me nene të tjera dhe në momentin që ndryshohen ato dy nene për të zgjidhur problemin e drejtimit këto dy formulime të reja hyjnë në konflikt me pjesën tjetër të neneve të ligjit për Akademinë e Shkencave. Nëse do të ndodhë kjo, ne do të kemi një ligj heteroklit, kundërthënës, i cili do ta kthejë Akademinë e Shkencave edhe më tepër në një institucion, i cili do të lëvizë midis kundërthënies logjike, midis gjërave që janë edhe po, edhe jo. T'ju them të drejtën, që një ligj të ketë edhe po-në, edhe jo-në dhe një nen që e afirmon dhe një nen që e kundërshton atë që e afirmon një nen tjetër, mua kjo më çon te logjika e Aristotelit dhe kurrë nuk mund të pajtohem me këtë situatë kontradiktore, sepse ligji për Akademinë e Shkencave, nëse do të bëhej kjo, pra, meqenëse nuk është mbajtur parasysh natyra *olistike*, tërësore, strukturore e ligjit, nëse këto amendamente do të hynin në fuqi, ligji do të bëhej heteroklit, do të humbiste pra homogjenitetin logjik, do të bëhej kundërthënës në vetvete, do të hynte në konflikt me ligje të tjera në fuqi dhe për rrjedhojë edhe me Kushtetutën në fuqi në Republikën e Shqipërisë, siç do ta trajtoj pak më poshtë.

Në relacion unë kam konstatuar shumë kundërthënie. Ligji procedural në fuqi në Republikën e Shqipërisë, pra Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë kërkon që relacioni, që shoqëron propozimet e amendamenteve, duhet të plotësojë minimumi dy pika: a) të tregojë objektivat e propozimeve të bëra; b) përse ato objektiva nuk arrihen me legjislacionin në fuqi; dhe ka një pikë të tretë, ku thuhet se, në rast të kundërt, pra kur këto dy të parat nuk plotësohen, Kryetari i Kuvendit mund ta kthejë projektligjin tek iniciuesit e tij.

Në pikën 2 të Rregullores së Kuvendit thuhet se projektligji hartohet në formën e një akti normativ dhe shoqërohet me një relacion, i cili përmban: a) objektivat që synohen të arrihen me miratimin e tij, b) argumentet ose objektivat nuk mund të arrihen me instrumentet ligjore ekzistuese, dhe pika 4, siç e thashë, Kryetari i Kuvendit, mund ta kthejë te nismëtari projektligjin e depozituar, në rast se nuk përmbush kërkesat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni. Ju ftoj ta shqyrtojme me hollësi relacionin e paraqitur!

Do të shohim se nuk ka absolutisht, asgjë sa i përket shtjellimit të objektivave që synohen me amendamentet në fjalë, pra, çfarë objektivi mendohet të arrihet duke bërë që jo vetëm kryetari, por të pestë anëtarët e kryesisë mund të qëndrojnë në të njëjtat poste dhe mund të *postulojnë* të njëjtat poste për 8 vjet radhazi, pra, edhe për dy mandate radhazi, duke e ndryshuar ligjin. Cili është objektivi? Nuk ka asgjë. Çfarë objektivash kërkohen të arrihen, kur propozohet që Kryetari të vazhdojë të qëndrojë në detyrë edhe pas moshës 75 vjeç, pra, konkretisht edhe 4 ose 8 vjet të tjera, afro deri 80-82 vjeç? Kërkoj të gjej objektivat dhe objektiva nuk ka. Përderisa nuk ka objektiva, nuk mund të ketë edhe argumente që të justifikojnë ndryshimet ligjore për t'i arritur ato objektiva. Përkundrazi ka propozime për ndryshime ligjore pa objektivat që duhen arritur. Mua më duket se kërkesa procedurale jo vetëm nuk është respektuar, por është kthyer mbrapsht.

Në njëfarë mënyre, kur kam analizuar, më falni, zotërinj deputetë, unë e kam mirëkuptuar se pse nuk i keni shpjeguar objektivat, sepse nuk ka objektiva.

Në Komisionin e Ligjeve, zoti Beqiraj, kam parë se keni thënë se me këto projektamendamente në Komisionin e Ligjeve nuk është bërë gjë tjetër veçse janë hequr disa formulime absurde të ligjit, por ato absurditete nuk i kam formuluar unë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, jo, bashkë jo. Unë kam qenë kundër jush në çdo pikë për ato absurditete që ju i quani tani, për ato që ju keni quënë flamurtari, dhe me të drejtën tuaj. Tani unë pyes, me respektin për atë që keni bërë, pse 4 vjet më vonë i quani absurditete? Kjo është e drejta juaj, por edhe një herë po them se nuk i kam formuluar unë, i kanë formuluar edhe persona që sot drejtojnë Akademinë e Shkencave.

Ligji për Akademinë e Shkencave kërkon që anëtari i Asamblesë që mbush moshën 75 ta ndërpresë të qenit anëtar i Asamblesë dhe merr statusin "Akademik emeritus". Atij që nga kjo moshë i hiqen disa të drejta, i hiqen edhe disa detyrime. Kjo pranohet, besoj edhe nga dy zotërinjtë deputetë sa kohë që i kanë lënë të pandryshuara këto nene. Mosha bën të vetën, kështu thotë ligji, nuk e them unë. Pyetja mbetet: kur pranohet me ligj, se pas moshës 75 vjeç fuqitë dhe energjitë e akademikut si rregull dobësohen, siç e thotë ligji, atëherë si është e mundur që, po sipas iniciuesve të amendamenteve, vetëm një person, një njeri, një supernjeri, një mbinjeri ligji ta konsiderojë se nuk preket nga faktori moshë, sikurse ligji e konsideron për të gjithë të tjerët duke më përfshirë edhe mua. Dhe kur them një mbinjeri, një supernjeri, nuk kam parasysh ndonjë person konkret, kam parasysh konceptin që na ofron ligji. A mund ta argumentojnë nismëtarët e këtyre



amendamenteve pse sipas ligjit energjitë bien disi, ose konsiderueshëm pas moshës 75 vjeç, e thotë ligji? Dhe po e tha ligji është një e vërtetë juridike, që unë nuk e diskutoj dot, se nuk jam as mjek. Uroj të mos ndodhë për persona të caktuar, por do të ndodhë dhe për mua sipas ligjit. Si është e mundur që për ligjin ndodh për të gjithë, me përjashtim të një njeriu, të atij që është kryetari i Akademisë së Shkencave? Unë nuk e kuptoj dot këtë.

A mund ta argumentojmë se kur kryetari i Akademisë bëhet 75 ose 80 vjeç është më i aftë, puna e tij bëhet më mirë, institucioni bëhet më mirë, institucioni bëhet më i zhdërvjellët, sesa kur kryetari është deri në 75 vjeç? Çfarë përmirësimi sjell që kryetari të jetë edhe mbi 75 vjeç? A ka ndonjë argument mjekësor, psikologjik, anatomik, që të bëhet ky ndryshim? Prandaj, unë mendoj se një amendament, siç e kërkon Rregullorja, bëhet për të çuar përpara infrastrukturën ligjore, për të përmirësuar punën. Sigurisht, nuk mund ta argumentojmë, dhe prandaj nuk e kanë argumentuar, mendoj unë zotërinjtë deputetë, dhe kanë bërë mirë që nuk i kanë hyrë kësaj valleje, sepse teksti do të ishte bërë komik. E kanë kuptuar. Mirëpo ligji është megjithatë i rreptë, ai u kërkon nismëtarëve të amendamenteve të argumentojnë objektivat e tyre se çfarë do të realizohet me këto dy ndryshime.

Problemi bëhet dhe më i mprehtë po të bëjmë pak dhe histori legjislacioni për Akademinë. Katër vjet më parë, po t'i referohemi kujtesës medieve, dokumenteve zyrtare, fjalimeve të Kryeministrit reforma e Akademisë së Shkencave nisi pikërisht nga kjo premisë. Kishte stanjacion të drejtuesve të Akademisë së Shkencave në krye të saj; Kryetari bëhej zëvendëskryetar, zëvendëskryetari bëhej kryetar, një rokadë e përhershme e tipit Putin Medvedev, por, sigurisht, në një formë dhe në një përmasë komike të një filxhani kafeje. Kurse tani amendamentet e paraqitura kërkojnë që drejtuesit e Akademisë së Shkencave të mund të qëndrojnë 8 vjet ose praktikisht edhe 12 vjet po të bëhet një interpretim dhe tani i bazuar në ligj, jo vetëm kryetari, por edhe zëvendëskryetari, jo vetëm zëvendëskryetari, por edhe sekretari shkencor, jo vetëm sekretari shkencor, por edhe kryetarët e seksioneve; të gjithë. Ku po shkojmë? Ne po kthehemi më keq se ishim. Unë si iniciuesi atij shqetësimi që ju erdhi ju dhe ju pastaj e ligjëruat në vitin 2019, kam të drejtë ta ngre zërin, përndryshe kam 4 vjet e ca të humbura kot nga jeta ime në Akademinë e Shkencave dhe në profesionin tim.

Kuptohet që teksti i projektamendamenteve nuk ka dashur të krijojë lëndime apo qejfmbetje midis anëtarëve të kryesisë; ose të gjithë, ose asnjëri; në këtë mënyrë ka krijuar atë që quhet solidaritet serial i grupit, i të 5 akademikëve në kryesi, të cilët sipas unitetit që u krijon

amendamenti nxiten tani për një votim për njëri-tjetrin, 5 votat të fituara për secilin në momentin e votimit. Pyetja është: përse amendamenti na kthen pas?

Sa do të doja të rrinte zoti Koçi!

Përse amendamenti na kthen pas? Në një situatë që vetë iniciatorët e tij e kanë quajtur 4 vjet më parë si një farsë zgjedhore. Të 5-të anëtarët e kryesisë kanë hapësira ligjore për të qëndruar edhe 4, ndofta edhe 8 vjet të tjera bashkë pa qejfmbetje në krye të institucionit. Unë pyes: a e nxit freskinë e drejtimit në Akademinë e Shkencave amendamenti i paraqitur, kur na kthen ligjërisht në një situatë më të keqe se katër vjet më parë?

Një çështje tjetër, që do të trajtoj, është se në relacion ka një konflikt midis propozimit dhe shpjegimit. Në relacionin e paraqitur bëhet apologjia e ligjit në fuqi për Akademinë e Shkencave dhe, gjithashtu, ndihet dëshira e kuptueshme për të treguar se veprimtaria e Akademisë së Shkencave ka qenë e mbushur me suksese në zbatim të këtij ligji. Ashtu qoftë, nuk kam asgjë në këtë pikë! Por pikërisht këtu nis një kontradiktë logjike e rëndësishme, e pashmangshme. Nëse Akademia e Shkencave ka vepruar konform ligjit në fuqi, nëse veprimtaria e saj është e mbushur vetëm me suksese, siç e ka relacioni, atëherë pse duhet ndryshuar ligji në fuqi? Nëse nuk tregohet në asnjë vend të relacionit të paraqitur as edhe një problem, as edhe një e metë, as edhe ndonjë frenim i ardhur nga cilido nen i ligjit në fuqi për Akademinë e Shkencave, për se duhen amendamentet? Pse na duhen këto amendamente? Kjo është pyetja që unë i bëj vetes dhe e bëj dhe publikisht, e bëj dhe te kolegët e mi, e bëj dhe këtu në këtë vend të nderuar të ligjbërjes.

Më tej, nëse këto suksese janë arritur nën drejtimin e një kryesie dhe një kryetari që kanë punuar me përkushtim mbi bazën e një ligji që u jepte vetëm një mandat, dhe jo dy mandate në vazhdimësi për të drejtuar, atëherë si mund të argumentohet se kalimi në modelin me dy mandate në vazhdimësi, me një kryetar mbi 75 vjeç premton të sjellë përmirësime? Sepse nuk është treguar asnjë problem. Ja, pra, që ligji në fuqi nuk paska penguar. Rregullorja e Kuvendit si ligj procedural ndalon prerazi çdo ndryshim të një gjendjeje ligjore në fuqi, sa kohë ajo nuk tregohet se bëhet pengesë për mbarëvajtjen e institucionit, për arritje të mëtejshme, madje, në këtë rast, siç thuhet në relacion, ligji paska qenë në tërë integralitetin e tij një faktor suksesi.

Tani po ju citoj relacionin e paraqitur nga zotërinjtë deputetë ku thuhet: “Ligji ekzistues nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave” është hartuar në përgjigje të kërkesave të drejta të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, por edhe të komunitetit akademik dhe shkencor të vendit, si dhe të interesit publik për të ndërtuar një Akademi Shkencash sipas modeleve më të suksesshme

bashkëkohore”. Ku është problemi? Pse duhet të atakojmë këtë ne, edhe qeverinë, edhe komunitetin shkencor, edhe opinionin publik? Nga arritjet dhe anët e ligjit në fuqi numërohen në mënyrë prioritare pikërisht edhe formulime që amendamenti kërkon t’i ndryshojë. Kjo e bën tekstin e relacionit vërtet të çuditshëm. Ja çfarë thonë dy zotërinjtë deputetë, nëse më lejojnë: “Ligji në fuqi nuk përfshin më kategorinë e akademikut të përhershëm, duke u dhënë akademikëve mbi 75 vjeç statusin “Emeritus” dhe duke i çliruar ata nga disa detyrime institucionale të pjesëmarrjes në veprimtarinë e Akademisë”. Në rregull. E kanë quajtur një arritje. Tani, pse duhet për një njeri ky rregull të priset? Ja, pra, konsiderohet si arritje që pas moshës 75 vjeç akademikët, duke përfshirë edhe kryetarin e Akademisë së Shkencave çlirohen nga disa të drejta dhe detyrime, pra edhe nga e drejta për të mbajtur poste pas moshës 75 vjeç. Ligji është koherent, këtu nuk është absurd. Po pikërisht këtë sukses të njohur nga ana e dy deputetëve në relacionin, që ata kanë firmosur, amendamentet që ata propozojnë. e sulmojnë, duan ta ndryshojnë. Tani çfarë të marr të vërtetë, që ligji bën mirë që i kufizon përgjegjësitë, të drejtat, kompetencat e akademikëve mbi 75 vjeç, apo bën keq? Ligjvënësi mua më duket kështu se do të futet në një kurth logjik, në një pamundësi për të ndërtuar koherencën e brendshme ligjore të aktit normativ.

Dhe më tej relacioni vazhdon po në këtë mënyrë, atje shkruhet e bardhë mbi të zezë, duke numëruar sukseset e ligjit në fuqi. Shikoni si thotë: “Gjithashtu, ligji i ri kufizoi mandatet e drejtuesve të zgjedhur të Akademisë deri në dy, duke krijuar kushtet për ripërtëritjen edhe të drejtuesve të Akademisë”. Kalimthi shënoj këtu se dy deputetët kanë bërë një lapsus, nuk them se nuk e njohin ligjin, por është një lapsus dhe duhet rregulluar. Ligji në fuqi nuk e kufizon vetëm në dy mandate të drejtën e kandidimit për anëtarët e Kryesisë, por e kufizon për dy mandate radhazi. Është një ndryshim i rëndësishëm. Ta kalojmë këtë lapsus, por duhet ta korrigjojmë disi.

Puna është se nga autorët e propozimeve amenduese kufizimi i mandateve, sipas ligjit në fuqi, shënohet si arritje e këtij ligji. Atëherë si është e mundur që edhe në këtë rast, pikërisht atë që ata lavdërojnë si arritje në relacion, pikërisht atë përcaktim ligjor kërkojnë ta ndryshojnë me propozimet e tyre. Si mohohet ajo që pohohet? Si kërkohet të ndryshohet ajo që quhet baza ligjore për sukseset e arritura? Cilat janë në të vërtetë objektivat që kërkohen të realizohen?

Një çështje tjetër është nëse është veprimtaria e Akademisë së Shkencave në përputhje me ligjin në fuqi? Pse e trajtoj këtë çështje? Kjo duket sikur nuk ka lidhje me amendamentet, por ka lidhje. Pse? Sepse të dy deputetët në relacionin e tyre e kanë marrë të mirëqenë supozimin se ligji për Akademinë e Shkencave dhe veprimtaria e saj kanë qenë në përputhje midis tyre. Ndërkaq unë

parashtrij se, së paku në dy drejtime themelore, midis veprimtarisë së Akademisë dhe ligjit në fuqi për të ka mospërputhje thelbësore. Mungesa e parë e përputhshmërisë. Ligji në fuqi për Akademinë në nenin 4 të tij thekson 19 role dhe funksione kryesore të Akademisë së Shkencave. Theksoj se në asnjërin prej tyre nuk parashikohet që Akademia e Shkencave të kryejë kërkim shkencor të mirëfilltë në nivelin e parë, pra të vendoset si agjenci kërkimore për të bërë kërkim shkencor duke u vendosur përballë objektivit të kërkimit shkencor në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Ligji, me të drejtë, ka parashikuar vetëm funksione këshilluese, promovuese, nxitëse, organizuese konferencash, inkurajuese, e të tjera, për Akademinë e Shkencave. Këtë e pranojnë dhe dy zotërinjtë e ndërtuar deputetë, të cilët thonë: “Ky ligj ridimensionoi dhe përcaktoi funksionet e Akademisë së Shkencave duke theksuar rolin këshillimor, rekomandues, promovues, botues, nxitës, bashkëpunues, bashkërendues të saj në sistemin e kërkimit shkencor të vendit”.

Mirëpo, në veprimtarinë praktike të Akademisë së Shkencave, si dhe në aktet zyrtare që përcaktojnë strategjinë e saj thuhet ndryshe, bëhet ndryshe. Bëhet ndryshe nga çka ka autorizuar ligji deri tani.

Unë dua të informoj zotërinjtë deputetë Petro Koçi dhe Ismet Beqiraj, si dhe të dëshmoj para komisionit si më poshtë:

Në fjalën e tij në mbledhjen e Asamblesë së Akademisë së Shkencave kushtuar analizës së veprimtarisë për vitin 2022 dhe perspektivat e vitit 2023 kryetari i Akademisë së Shkencave thotë: “Akademia u kthye në qendrën kryesore të organizimit të ngjarjeve më të mëdha të karakterit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar në të gjitha fushat kryesore të shkencës. Ajo rimori dhe luajti rolin aktiv parësor për kërkim-studimin në shkencë, veçanërisht në Albanologji dhe në fushat më sfidante të saj”. Dhe më tej, po aty, Kryetari i Akademisë së Shkencave pohon synimin për kthimin e Akademisë së Shkencave, të strukturave pranë saj, në qendrën më me peshë të kërkimit shkencor në vend. Ai sqaron edhe detaje duke thënë se ky nuk ka qenë vetëm synimi, por është bërë në praktikë. Ja se çfarë thotë: “Këtë detyrë madhore të shtruar nga kjo Asamble, mund të themi se strukturat tona në bashkëpunim me institucionet e vendit e kanë kryer në përmbajtje, por ajo akoma nuk është formalizuar”.

Shihet qartë anashkalimi i përcaktueshmërive ligjore që shfaqet në platformën strategjike mbi të cilin punon kryesia.

Mungesa e dytë, që do të vë në dukje, e përputhshmërisë, midis veprimtarisë dhe ligjit, në të njëjtin dokument zyrtar të strategjisë Kryetari i Akademisë së Shkencave shpall se po punohet,

ju lutem, më dëgjoni, kthimin e Akademisë së Shkencave në institucionin më të lartë të kërkimit dhe koordinimit të vetë sistemit nëpërmjet vendosjes së saj të qendrave të njësisive kryesore me impakt kombëtar. Në këtë mënyrë kryesia e Akademisë shpalos konceptin e saj për sistemin shkencor në vend që, sipas përkufizimeve që sapo dëgjuat, duhet organizuar: 1. Vertikalisht, me në majë të tij Akademinë e Shkencave, i koordinuar sipas një qendre të vetme, Akademi e Shkencave, i përqendruar në thelb po tek Akademia e Shkencave.

Është e drejta e gjithkujt të japë konceptet e veta për sistemin e shkencave në Shqipëri dhe kërkimit shkencor, por detyrimet ligjore janë tjetër gjë. Kjo platformë strategjike e kryetarit të Akademisë bie në kundërshtim me ligjin në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë me numër 80/2015, sipas këtij ligji, të cilit i kundërvihet strategjia e kryesisë së Akademisë së Shkencave, sistemi i kërkimit shkencor nuk është i ndërtuar vertikalisht me bazë dhe majë, si piramidë, nuk është i përqendruar dhe as nuk pranohet se mund të koordinohet, siç thuhet praktikisht se bëhet, nga Akademia e Shkencave apo nga kryetari i saj.

Në nenin 95, pika 1 e ligjit “Për arsimin e lartë” thuhet: “Veprimtaritë e kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë realizohen mbi bazën e programeve dhe projekteve të miratuara nga organet kompetente në këto institucione, në përputhje me statutin dhe rregulloret e institucionit.”

Relacioni nuk bën transparencën e burimeve të informacionit, nga i ka marrë. Duke parë relacionin në fjalë, shikon një listë me arritje që zotërinjtë deputetë i paraqesin si suksese të Akademisë së Shkencave. Unë nuk hyj në këtë diskutim me zotërinjtë, se nuk është vendi, por për mua problemi është se ku i kanë gjetur propozuesit e amendamenteve këto informacione. Në çfarë ekspertize mbështeten ata për të bërë këtë analizë që dëshiron të vlerësojë aktivitete në fusha që nisin nga sizmologjia, tek imunologjia, te nanoteknologjia, te gjuha shqipe, te historia? Unë pyes: a janë konsultuar dhe a e kanë marrë pëlqimin nga ana e kryesisë së Akademisë së Shkencave iniciuesit e këtyre projektamendamenteve, sidomos për dy çështje: për atë që të kenë mundësi të zgjidhen dy mandate radhazi dhe për të pasur një kryetar që nuk e ndërpret mandatin në moshën 75 vjeç? Pra, ka mundësi: e para, që ata i kanë gjetur vetë këto informacione shkencore, dhe mundësia e dytë është që i kanë marrë informacionet duke krijuar kontakte, duke bërë takime koordinuese me Akademinë e Shkencave. Nuk ka asgjë të keqe, por informacionet e marra në këtë

rast duhet t'i referoni në burime të dokumentuara parësore, ndryshe pa referenca në shkencë e quajmë plagjiaturë.

Rregullorja e Kuvendit, pra ligji për procedurat e ligjbërjes, kërkon që deputetët, që ndërmarrin iniciativa ligjore, duhet të dëshmojnë, të tregojnë, të shpallin dhe t'i regjistrojnë të gjitha takimet e tyre, kohën, tematikat e diskutimit, personat me të cilët janë takuar, me të gjitha agjencitë për të cilat ata ndërmarrin iniciativa ligjore. Pra, çështja ka dy mundësi ose deputetët i kanë vëzhguar dhe i nxjerrin vetë këto informacione, pra i mbajnë vetë përgjegjësitë për saktësinë e tyre, dalin në rolin e ekspertëve, ose ua ka ofruar Akademia e Shkencave dhe në këtë rast ligji parashikon disa detyrime për relacionin.

Kodi i Sjelljes së Deputetit, i cili ka hyrë në fuqi me vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 61/117, në nenin 21, pika 2, shprehet: “Transparenca e kontakteve të deputetit me lobistët, organizatat e shoqërisë civile, të grupeve të interesit zbatohet për të gjitha rastet, përfshirë edhe kontakte jashtë mbledhjeve të Kuvendit dhe komisioneve të tij”.

Pika 3: “Deputeti duhet t'i bëjë publike takimet me ta, objektin e diskutimeve, shkallën e mbështetjes që do të sigurojë për kërkesat e paraqitura nga subjektet kërkuese”.

Pika 4: “Këto dokumente duhet të depozitohen në komisionin parlamentar ose në sekretarinë e Kuvendit”. Nuk e di, zonja Açka, unë nuk i kam gjetur dot.

Pika 5: “Dokumentet shkresore publikohen në faqen zyrtare të komisionit parlamentar”.

Këto informacione i kam kërkuar në të gjitha drejtimet, siç e kërkon ky kod, por nuk i kam gjetur.

Ju lutem, edhe pak durim nga ju, sepse do të hyj në përmbajtjen e dy amendamenteve. Pra, a është mundur dhe çfarë ndodh me një akademik 75 vjeç? Ritheksoj se amendamenti kërkon ndryshimin e dy neneve të ligjit “Për Akademinë e Shkencave”, pa marrë parasysh se ky ndryshim përputhet ose jo me pjesën tjetër të përmbajtjes së ligjit që lihet e paprekur. Në qoftë se do të hyjnë në fuqi amendamentet e propozuara, atëherë do të kishim paradoksalisht dy norma ligjore ose fakte juridike: a) edhe një kryetar të Akademisë që vazhdon të qëndrojë në postin e tij pas moshës 75 vjeç; b) edhe rregullin që një anëtar i Asamblesë së Akademisë së Shkencave shndërrohet në emeritus pas moshës 75 vjeç. Këtu nis kontradikta ligjore. A mundet që dikush, i cili, sipas përcaktimit ligjor, nuk është më pjesë e Asamblesë ose nuk ka më të drejta dhe detyrime të plota atje, të vazhdojë të mbetet kryetari i saj? Ky është problemi logjik. Ky është problemi që vjen nga matematika dhe algjebra e bashkësive logjike.

Po të pranoni këto, nuk do të pranoni rregullat e logjikës formale, dhe unë nuk di se si mund të votohet nëse do t'i pranoni rregullat e logjikës formale apo nuk do t'i pranoni. Çfarë kërkon ligji “Për Akademinë e Shkencave” në nenin 11 të tij të titulluar “Zgjedhja e kryesisë”? Ai thotë: “Zgjedhja e kryetarit të Akademisë bëhet nga anëtarët e Asamblesë”. Pra, duhet të jesh anëtar i Asamblesë për t'u bërë kryetar i saj. Nuk ka gjë më ligjore, më logjike, por çfarë parashikon ligji “Për Akademinë e Shkencave” kur flet për atë se çfarë quhet Asambleja e Akademisë së Shkencave?! Ju lutem, dëgjojeni! Cilët janë ata që e përbëjnë Asamblesën e Akademisë së Shkencave?!

Neni 6 i ligjit “Për Akademinë e Shkencave” thotë: “Asambleja është trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve, e cila përbëhet nga akademikët dhe akademikët e asociuar, askush tjetër. Në vazhdimësi neni 6 thotë: “Këta do të quhen anëtarë të Asamblesë”, pra gjithçka është e qartë. Në Asamble, sipas nenit të cituar më sipër, në mënyrë strikte bëjnë pjesë vetëm akademikët dhe akademikët e asociuar, askush tjetër. Si për ta bërë më të qartë, neni 6 vazhdon: “Numri i akademikëve është deri në 30, ndërsa numri i akademikëve të asociuar është deri në 10”, pra asnjë më shumë. Pra, për ta kuptuar edhe më mirë përkufizimin ligjor të anëtarëve të Asamblesë neni 14 i ligjit me titull “Vlefshmëria”, pika 1, thekson: “Me zgjedhjen si anëtar i Asamblesë personi fiton titullin “akademik” ose “akademik i asociuar” (identiteti është i plotë)”. Në këtë bashkësi ligji nuk ka përfshirë as anëtarët e nderit, as anëtarët korrespondentë, as anëtarët e jashtëm dhe, siç e shikoni, as anëtarët emeritus. Këta të fundit kanë një përkufizim tjetër ligjor, nuk mund t'i ndërrojmë ne këto përkufizime, hajdeni ta ndërrojmë të gjithë ligjin, gjë që unë dua t'ju propozoj. Dua të propozoj që të ndërmerret një nismë, dua t'ua propozoj të dy deputetëve, për ta ndryshuar të gjithë ligjin “Për Akademinë e Shkencave”, pse jo, por jo ta bëjmë në mënyrë kontradiktore kundërthënëse, ku të shkelen parimet bazë të logjikës së Aristotelit. Aq e qartë është kjo, sa që ligji shprehet në po atë nen: “Ata, akademikët emeritus, nuk përfshihen as në llogaritjen e kufizimeve të pikës 1 të këtij neni.” Çfarë do të thotë “nuk përfshihen në llogaritje”?! Pra, nuk përfshihen te numri 30 akademikë plus 10 akademikë të asociuar që përbëjnë Asamblesën, sipas nenit 6. Në këtë mënyrë, sipas përcaktimeve ligjore të mësipërme, ne kemi anëtarë të Asamblesë me të drejta, me detyra dhe me kompetenca të plota, kemi anëtarë nderi, anëtarë korrespondentë, anëtarë të jashtëm, si dhe akademikë emeritus, të cilët, sipas përkufizimit bazë, përkufizohen si anëtarë të Akademisë, por nuk janë anëtarë me të drejta të plota dhe detyrime të plota, madje nuk hyjnë as në përcaktueshmërinë e përkufizimeve se çfarë quan ligji anëtar të Asamblesë. Fakti që quhet anëtar

i Asamblesë, nuk ndryshon gjë, sepse edhe anëtarët e nderit dhe të jashtëm quhen po ashtu anëtarë, por nuk janë në kuptimin strikt të saj. Neni 14 e përforcon këtë edhe nëpërmjet parashikimit financiar. Shikoni çfarë thuhet në pikën 3 të nenit 14: “Titujt “akademik” dhe “akademik i asociuar” përfitojnë një shpërblim mujor të përhershëm për titull në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave”. Pra, Këshilli i Ministrave paguan këta sipas ligjit, jo të tjerët, nuk paguan anëtarë nderi dhe anëtarë të jashtëm. Kur një akademik emeritus, pra që ka përmbushur moshën 75 vjeç, sipas ligjit kthehet automatikisht në emeritus, nuk është më anëtar i asaj bashkësie, që e përcakton ligji, të përbërë vetëm nga akademikët dhe akademikët e asociuar, ose është pa të drejta dhe detyrime të plota. Si mund të jetë ai kryetar i një bashkësie kur nuk është një anëtar?

Krijohen situata staturore juridikisht hibride. Çfarë dua të them me këtë?! Si mundet që një kryetar akademie, që ka kaluar moshën 75 vjeç, pra sipas ligjit, dhe ai është emeritus dhe është i privuar nga shumë detyrime dhe të drejta, të ushtrojë detyra të shtuara si kryetar?! Pra, ligji 75 vjeç ia heq të drejtat dhe kompetencat, ia heq këto detyra. Pse? Sepse ky ka mbushur 75 vjeç dhe të gëzojë moshën e tij, të bëjë çfarë të mundet. Në pikërisht me ligj i themi: ne kështu ju konsiderojmë, por ama njërin midis jush do ta konsiderojmë të tillë që do t'i vendosim detyra më të mëdha dhe më të fuqishme. Ku do të shkojmë me këtë logjikë?!

Le t'i shikojmë me radhë se çfarë privimesh në të drejta dhe në kompetenca ka një akademik emeritus. Privimet, sipas pikës 4 të nenit 6 të ligjit: “Anëtarët e asamblesë që mbushin moshën 75 vjeç marrin statusin e anëtarit emeritus, nuk përfshihen në llogaritjet e përkufizimeve të pikës 1 të këtij neni”. Pra, numri i emeritusve mund të jetë pa kufizim, sepse ata nuk llogariten te numri i anëtarëve të Asamblesë, që i përcakton si të tillë pika 1 e këtij neni.

Neni 8, pika 7, thekson: “Mospjesëmarrja e anëtarit emeritus nuk e cenon arritjen e kuorumit apo përcaktimin e shumicave të cilësuar”. Çfarë do të thotë kjo?! Si vjen, si nuk vjen, funksionimi i Asamblesë bëhet, si të duash, pra, po pate mundësi hajde, po nuk pate mundësi, mos hajde, si të jesh me shëndet ose si të jetë plani i agjendës së ditës.

Pika 10 e nenit 9 thekson: “Anëtarët emeritus përjashtohen nga detyrimet e pikës 2 të këtij neni”. Çfarë thotë pika 2? Thotë: “Anëtarët e Asamblesë kanë të drejta dhe detyra të marrin pjesë aktive në mbledhjet e Asamblesë, seksioneve dhe komisioneve”. Pra, ndryshe çfarë do të thotë kjo? Ligji nuk e lejon një emeritus të marrë pjesë aktive në veprimtarinë e Akademisë, të seksioneve, të komisioneve. Ai po të dojë merr pjesë, nëse jo, pastaj është i lirë të mos marrë pjesë, nuk ka asnjë detyrim ligjor.



Pika 10 e nenit 9 thekson: “Anëtarët emeritus përjashtohen edhe nga e drejta për t’u zgjedhur në organet drejtuese”. Pse ligji i përjashton ata nga e drejta për t’u zgjedhur, nisur nga një moshë prej 75 vjetësh? Është qartë pse, ligji nuk nënkupton që pas asaj moshe ulen në parim aftësitë e njeriut për të drejtuar me efikasitet një institucion si Akademia e Shkencave. Nuk e them unë, e thotë ligji dhe, kur e thotë ligji, juridikisht çdo avokat thotë që ligji ka të drejtë, nuk ka vend ta diskutojmë. Mund të mos jesh dakord me këtë, dhe unë nuk jam dakord me të, por jam i detyruar ta zbatoj. Ligji kështu e ka zgjedhor, t’i besojë dhe ta normativizojë. Nëse amendamentet e propozuara në këtë kuadër do të hynin në fuqi, ligji “Për Akademinë e Shkencave” do të hynte në një kundërthënie të brendshme. Nga njëra anë asgjë nuk do ta detyronte akademikun emeritus të merrte pjesë në veprimtaritë e Akademisë së Shkencave. Nga ana tjetër, kryetari i Akademisë së Shkencave me statusin sipas ligjit, nëse ka mbushur moshën 75 vjeç, pra është bërë emeritus edhe ai, si kryetar ka disa detyrime që ia detyron ligji. Çfarë thotë ligji?! Neni 13 “Detyrat e kryetarit”: “të drejtojë dhe të organizojë punën e Akademisë”. Tani cilën të zgjedhë nga këto?! Nëse amendamentet e propozuara hyjnë në fuqi, atëherë do të kemi këtë natyrë kontradiktore logjike të ligjit. Kryetari i Akademisë do të ishte i detyruar nga ligji, sipas nenit 14, të drejtonte punën e Akademisë, ndërsa si emeritus ai do të ishte i lirë që, nëse do të donte, mund të punonte, nëse jo, mund të mos punonte, mund të mos shkonte fare në mbledhje e të tjera me radhë. Tani mendoni se mund të ndërtojmë një status juridik ku i njëjti person juridik edhe të ketë detyrimin, edhe të mos e ketë detyrimin? Në cilin institucion të Republikës së Shqipërisë apo të një shteti të së drejtës mund të ekzistojë kjo?!

Së fundi, shkelet barazia e akademikëve para ligjit. Me mbushjen e moshës 75 vjeç, anëtarët e Asamblesë përgjithësisht kalojnë në një status, i cili u heq të drejtat dhe detyrimet që ata kishin një orë para se të mbushnin moshën 75 vjeç, por amendamentet na thonë kujdes, të gjithë, por me përjashtim të njërit, atij që është kryetari i Akademisë së Shkencave. Askush nga akademikët nuk mund t’i ketë pas moshës 75 vjeç të drejtat e tyre si akademik apo akademik i asociuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Me përjashtim të njërit, i cili mund të marrë dhe të ushtrojë më shumë kompetenca, sepse ai drejton Akademinë. I njëjti ligj krijon pabarazi mes akademikëve emeritus, njëri prej tyre privilegjohet nga të tjerët, në krahasim me të ngjashmit e tij. Po çfarë thotë neni 18 i Kushtetutës?! “Të gjithë janë të barabartë para ligjit”.

Së fundi, ju kërkoj ndjesë, të nderuar deputetë, unë mendoj se amendamentet që ju keni propozuar, nuk mbajnë parasysh, nuk janë në përputhje apo vijnë në kundërshtim me pikën “a” të nenit 2 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë; me pikën “b” të nenit 2 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë; me nenin 94 të ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”; me nenin 95 të po këtij ligji; me pikat 2, 3, 4 dhe 5 të Kodit të Sjelljes së Deputetit dhe me pika të ndryshme, siç i përmenda, të neneve 4, 8, 9, 11, 13 dhe 14 të ligjit “Për Akademinë e Shkencave” dhe në fund me nenin 18 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

Nëse më lejohet, edhe ndonjë rekomandim... Në këto kushte, çfarë kam ardhur unë këtu për të paraqitur?! Një ftesë për deputetët iniciatorë që ta tërheqin këtë nismë, duke i riparë edhe një herë se sa ato ndryshimet që ata duan në ligj, integrohen me nenet e tjera të ligjit për Akademinë e Shkencave. Nëse duhet, unë i propozoj që të rimarrin një iniciativë për ta ndryshuar të gjithë ligjin për Akademinë e Shkencave, aq më shumë që qarkullon një projektligj për kërkimin shkencor dhe për sistemin e kërkimit shkencor. Të mos i bëjmë gjërat që në fillim arnojmë dy-tri gjëra këtu, nuk e di për çfarë urgjence, ndërkohë i kemi vënë këto dy ndryshime që bien në kontradiktë me të gjithë frymën e ligjeve në Republikën e Shqipërisë. Unë u bëj thirrje deputetëve, zonjave dhe zotërinjve të komisionit, që t’i shqyrtojnë mundësisht me hollësi kundërshtitë e mia. Unë do ta lë dokumentin këtu dhe, po të duan, le t’i ballafaqojnë, le të kërkojnë ekspertizë të pavarur, juridike, shkencore, etike e të gjitha me radhë.

Unë dua t’ju bëj me dije juve, zonja Flutura Açka, si kryetare e nderuar e këtij komisioni, se relacioni që shoqëron amendamentet në fjalë, nuk i plotëson kërkesat e procedurave ligjvënëse dhe, si i tillë, mendoj se nuk mund të shqyrtohet nga ky komision. Unë i lutem Kryetares së Kuvendit të ushtrojë kompetencën e saj dhe ta kthejë tek iniciatorët këtë projektligj, meqenëse ai nuk përmbush kërkesat e procesit ligjvënës dhe unë, kur të dal nga komisioni, do ta depozitoj këtë kërkesë drejtuar zonjës Lindita Nikolla, bashkëngjitur materialit tim me këtë lutje.

Së fundi, ftoj Kuvendin e Shqipërisë të iniciojë reflektime të tjera për ta përmirësuar kuadrin ligjor të kërkimit shkencor në vend. Mendoj se situata që krijojnë amendamentet në fjalë, ligjërisht është e paqartë. Nuk e kuptoj pse ky nxitim. Një politikë e matur do të ishte mungesa e nxitimit. Akademitë janë institucione afatgjata, ndryshojnë ngadalë në kohë, nuk bëhen me arnime ligjore dhe as me praktika ligjore urgjente. Unë propozoj që komisioni të marrë ekspertizë, të dëgjojë dhe të ballafaqojë alternativat e paraqitura me një komunitet profesorësh brenda dhe jashtë Akademisë së Shkencave, ndoshta edhe të sqarojë me juristë dhe ekspertë të pavarur kuptimin e

mjaft koncepteve juridike që paraqiten në ligj. Ndoshta të presë edhe formulimin dhe shqyrtimin ligjit për shkencën që duket se është si draft dhe qarkullon, vetëm atëherë mendoj se mund të merret një vendim i matur, përfundimtar, i pjekur që e ndihmon Akademinë e Shkencave. Unë nuk e kuptoj këtë urgjencë, ndërkohë që në vjeshtë, ndoshta deri në fund të vitit, është e gjithë koha për ta bërë këtë punë me pjekuri, jashtë urgjencës që ndoshta lidhet edhe me ankthet e disa interesave të vegjël personale.

Ju falënderoj shumë dhe ju kërkoj ndjesë për kohën që ju mora!

**Flutura Aça** – Profesor Fuga, shumë faleminderit! Në syrin tim ishit i saktë, shterues dhe me argumente, siç duhet të jenë gjërat tona, sidomos nga ky Kuvend. Me sa rezulton, me sa thatë ju dhe me sa nuhasim edhe ne të tjerët, sidomos opozita, do të ishte më mirë që të mos i ishte ndërruar emri këtij projektligji, të mos ishte thënë “projektligj për disa shtesa”, por të ishte bërë ligji “Gjinushiada” dhe e kishim firmosur, e kishim vulosur dhe e kishim kaluar tutje.

Gjithsesi, kolegët mund të kenë pyetje. Unë kam një pyetje për ju, para se t’ua jap fjalën kolegëve të tjerë që mund të kenë pyetje. Nuk e di nëse jeni informuar për një shkresë që ka ardhur nga Akademia e Shkencave...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ne i kërkuam edhe anëtarët e tjerë të Asamblesë, nëse dëshironin. Sigurisht, po të vinin të gjithë, do të kërkonim një sallë më të madhe për të gjithë, pse jo, le të ishte një gjë më shteruese, por kanë dërguar vetëm një shkresë, ku thonë mendimin e tyre që janë dakord me të gjitha ndryshimet që sjell ky projektligj, i cili do të bëhet shpejt ligj, dhe janë dakord dhe kanë firmosur 37 akademikë ose anëtarë të Asamblesë. Por ajo që vërej, zoti Fuga, është se aty ku kanë vendosur ata firmën, ka një gjë tinëzare, po e them kështu, sepse jam e bindur që është tinëzare, sepse, pasi bëjnë përshkrimin, thuhet që ndryshimi në ligj do të jetë vetëm për hapjen e mëtejshme të studuesve shqiptarë jashtë vendit. Kushdo që të jetë, edhe unë po të jem, apo jo, kur e mendoj se është një gjë kaq e bukur, e vendos firmën. Këtu është e gjithë tinëzaria. Ju nuk e njihni këtë shkresë. Unë do të përpiqem që sekretarja t’jua dërgojë që të njiheni edhe ju me kolegët tuaj që kanë firmosur këtu, pra 37 veta, që nuk e kanë idenë fare se për çfarë bëhet fjalë, vetëm kanë firmosur, pa e ditur se po e firmosin me të drejtë për hapjen e mëtejshme të studuesve shqiptarë jashtë vendit, jo për këto, për të cilat folët ju...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ja, ashtu është, pra është fiks ashtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe unë të jem, bie viktimë e kësaj gjëje, sepse mendoj se është një gjë shumë e bukur. Aty është dhe tinëzaria...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E pyeta zotin Fuga, a keni dijeni për këtë shkresë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Beqiraj, e pyeta zotin Fuga nëse ka dijeni për shkresën me numër protokollit 556, datë 07 korrik 2023. A është informuar ai për ta firmosur këtë shkresë, a është dakord ose jo për këtë gjë?

Unë këtë pyetje kisha, sepse është anëtar i Asamblesë dhe dua të di nëse ka dijeni.

**Artan Fuga** – Nuk kam asnjë dijeni dhe, nëse mund të bëj një shtesë, si anëtar i Akademisë, duhej që atë shkresë të ma dërgonin edhe mua, që edhe unë të shprehja aprovimin ose mosaprovimin, por, siç duket, e kanë konsideruar që jam i përjashtuar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mund të isha edhe kundër dhe të shënohej atje që jam kundër, por nuk dua të hyj në interpretime të tjera, sepse mund të dal jashtë teme.

Faleminderit!

**Flutura Açka** – Faleminderit, zoti Fuga!

Unë vetëm këtë pyetje kisha për ju!

Cili nga kolegët ka pyetje?

Po, zonja Zhupa.

**Ina Zhupa** – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, jam një nga relatorët e ligjit, profesor Fuga, dhe unë njihem në këto sekonda me këtë shkresë, ndërkohë që duhej të kisha kohë për të përgatitur edhe relacionin. Me sa shikoj, shkresa ka datën 5 korrik, sot është data 10 korrik, hajde merre vesh tani se kush e ka fajin. Shkresa thotë: Tiranë, datë 05 korrik 2023, pa numër protokollit dhe ka tekstin si më poshtë vijon: “Mendimi i anëtarëve të Asamblesë së ASH-së mbi variantin përfundimtar të projektligjit të ASH-së të paraqitur në Kuvend. Pasi u njohëm me variantin e paraqitur nga deputetët nismëtarë, - se si dhe se ku u njohën, nuk e dimë, - pajtohemi plotësisht me të dhe e gjejmë në parim në përputhje të plotë, madje të përmirësuar nga ana teknike me projektin e miratuar nga Asambleja me vendimin e saj nr. 50, datë 08.09.2022.” Pra, ka pasur një vendim të Asamblesë nr. 50, datë. 08.09.2022, për

të bërë ndryshime ligjore, sipas kësaj shkrese. “Pasi pasqyrohen arsyet kryesore pse u ndërmor ky ligj, siç është hapja e mëtejshme e studiuesve shqiptarë jashtë vendit.” Fjalja është pa kuptim, sepse thotë: “siç është hapja e mëtejshme e studiuesve”. Hapen studiuesit, jo hapet Akademia. Ky është niveli i shkresave të Akademisë së Shkencave, dhe këtu ka “e tjera.”, dhe disa anëtarë që nuk e dimë cilët janë, sepse shikoj disa firma të hedhura kështu... Unë do ta publikoj, do t’jua vë edhe juve në dispozicion. Pra, nuk ka një listë serioze, por ka disa firma të hedhura në një shkresë. Pra, ky është mendimi që sjell Akademia e Shkencave dhe ne njihemi në këto momente që njiheni edhe ju, këtë dua ta theksoj.

Profesor, pyetjet e mia janë këto: a jeni lajmëruar ju nga Asambleja e Akademisë së Shkencave për mbledhje në datën 5 korrik në lidhje me shqyrtimin e këtij projektligji?

A keni dijeni për vendimin nr. 50 të datës 8.9.2022, nëse keni dhe nëse dini që të ketë lidhje me këto ndryshime ligjore që kanë paraqitur Koçi dhe Beqiraj?

A keni ju dijeni që të gjithë akademikët në Akademinë e Shkencave janë mbi moshën 75 vjeç dhe për këtë arsye do të duhet që të ndërhyjë legjislatori, sepse nuk kemi mundësi që të zgjedhim një kryetar akademie nën moshën 75 vjeç, se mund të jenë të gjithë në prag të moshës apo të gjithë 75 vjeç dhe kemi një ngërç e na duhet që të hyjë legjislatori në këtë rast?

Profesor, kryesia e Akademisë së Shkencave, që kërkon të ripërsërisë veten në të njëjtin funksion për të paktën 12 vjet, ka bërë edhe një reagim. A keni ju dijeni që kryesia e Akademisë së Shkencave të ketë hapur një debat apo të ketë kërkuar diskutime me anëtarët e Asamblesë së Akademisë së Shkencave për këto ndryshime?

Për sa i përket thelbit, ju ishit shumë i qartë dhe arsyet e kundërshtimet tuaja janë thelbësisht ligjore. Ajo që unë dua të shtoj te kjo, para se të vijë momenti i relacionit, është fakti që ju ngritët një pyetje që nuk e kuptoni urgjencën. Për këtë po ju përgjigjem unë: urgjenca është se mbaron mandati i Skënder Gjinushit, i cili mbush edhe moshën 75 vjeç, po të marrë një mandat të dytë. Kjo është urgjenca që, me sa duket, kanë zotërinjtë që nga relatorët, zoti Beqiraj, nuk e ka fshehur as në këtë komision miqësinë, lidhjen dhe....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mund t’u referoheni edhe procesverbaleve me kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe me akademikët, meqenëse ishte një nga pyetjet që ju keni ngritur në paraqitjen tuaj.

Për sa i përket thelbit, unë i rezervoj vetes të drejtën të shprehem kur të relatoj mbi ligjin. Të gjitha shkeljet që ju evidentoni, janë absolutisht të qëndrueshme dhe janë pjesë e relacionit që do të lexohet pas pak për shqyrtimin e ligjit.

Pyetja e fundit: a mendoni se, duke hequr, meqenëse për moshën u pa e qartë edhe shkelja e Kushtetutës, fjalën “radhazi” dhe duke lejuar gati tri mandate një kryetari, arrihet qëllimi për të cilin legjislatori ndërhyri edhe në vitin 2019 për ta demokratizuar Akademinë e Shkencave, për të mos e kapur një person Akademinë e Shkencave, për të mos pasur staniacion në krye të Akademisë së Shkencave dhe për të pasur mundësi që Akademia të jetë një forum demokratik?

Faleminderit!

**Flutura Açka** – Faleminderit, zonja Zhupa!

Po, zoti Fuga.

**Artan Fuga** – Faleminderit, zonja Zhupa, për pyetjet!

Do të përgjigjem në mënyrë koncize. Po e filloj nga pyetja e fundit: a mendoni se me këto dy amendamente arrihen qëllimet që Akademia të jetë një mjedis demokratik dhe të jetë në frymëzimin e asaj reforme që u bë katër vjet më parë?

Ju lutem, ta mirëkuptoni pozicionin tim dhe përgjigjen time! Unë nuk u kam hyrë fare qëllimeve. Pse? Unë jam i formuar në disa drejtime të shkollave juridike të jurisprudencës, të mos hyjmë këtu në leksione, që nga pikëpamja ligjore qëllimi dhe dobia e një amendamenti është një çështje shumë relative. Një politikë e caktuar thotë se është e dobishme dhe një mendim tjetër politik apo një grupim tjetër politik apo një filozofi tjetër thotë që nuk është e dobishme. Po të shikojmë edhe historinë e akademive europiane, në vitin 2008, 6 muaj si kisha hyrë në Akademi, i kam paraqitur të ndjerit kryetar të Akademisë atëherë, propozimet e mia duke studiuar 10 apo 15 akademi europiane, nuk e kam filluar sot këtë përpjekje, dhe duhet të kuptoni që nuk kam asgjë me asnjëri, nuk më intereson fare plani personal. Në vitin 2008, shkoni edhe merrini gjërat, do të shikoni që fillova atje. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se ka eksperiencë të ndryshme. Pra, po të diskutojmë për qëllimet për dobitë, unë nuk kisha pse të vija fare këtu, zonja Zhupa, sepse do të më thoshe: “Ti mendon ashtu, ne e mendojmë kështu”, duke e hequr qëllimshmërinë, duke e hequr dobinë, të cilat, me thënë të drejtën, nuk i kam gjetur në relacion, ashtu siç thashë, dhe i qëndroj mendimit tim. Unë i qëndroj asaj që a respektohet ajo që quhet logjika e ligjit, pra, këto ndryshime a mund t’i bëjmë apo jo ligjërisht?! Pozicioni im është: sado që të kemi qëllime të mira, duhet të gjejmë rrugë të tjera ligjore për t’i zgjidhur, sepse fryma e ligjit dhe shteti i së drejtës ky është, pra,

nuk mund të shkel ligjet për një qëllim të mirë. Kjo është baza e të gjithë shtetit. Ju e dini mirë që po e hodhëm poshtë këtë dhe filluam arsyetojmë që ligjet kanë dobi dhe janë të mira, por nuk respektojnë kriteret as procedurale, as për të qenë konform Kushtetutës, as për të qenë konform ligjeve të tjera në fuqi, unë nuk i hyj fare këtij problemi. Ky është pozicioni im dhe këtë e mbroj po aq sa e di që jam gjallë. Këtë nuk e luaj dot, sepse nuk kam mundësi, me duhet të rrezoj 35 vjet formimin tim që të pranoj një gjë të tillë. Kjo ishte për pyetjen e fundit.

Lidhur me pyetjen nëse kam dijeni që kryesia ka bërë debat për këto ndryshime, të cilat propozohen në amendamente. Unë di që në mbledhjen e analizës së vitit 2022 (mund ta kërkonti, është e regjistruar me video), ku akademiku Apollon Baçe i ka bërë pyetje kryetarit të Akademisë: “A dini gjë dhe a keni bërë ju propozim për këto dy amendamente?” (unë po e jap të përmbledhur, por mund të shkoni ta verifikoni), dhe përgjigjja ishte: “Ne, meqenëse nuk jemi një agjenci që mund të inicioj nisma ligjore, kemi biseduar me deputetë (unë nuk i di emrat) dhe flitet për pjesën tjetër, ndërsa për sa i përket ndryshimit të mandateve dhe moshës, kjo është një çështje e deputetëve”. Ky është informacioni që unë kam.

Pyetjes, nëse jam njoftuar të vijë në këtë mbledhje, apo për këtë material, e dhashë përgjigjen dhe ajo ishte “Jo”.

Pyetja: “A ka akademikë, që nuk janë 75 vjeç?”, unë e kuptoj pyetjen tuaj, por ligji e thotë, neni 6, që në Akademi janë 30 plus 10, të cilët nuk mund të jenë 75 vjeç, sepse po të bëhen 75 vjeç, nuk mund të jenë te 30 plus 10, pra, nuk janë anëtarë të Asamblesë. Një kryetar që kalon 75 vjeç, nuk është më anëtarë i Asamblesë, pra, që një trëndafil të jetë trëndafil, në fillim duhet të jetë lule dhe, nëse nuk është lule, nuk mund të jetë trëndafil.

Pyetja e fundit që ju keni bërë, unë jam edhe i prekur, por njeriu duhet t’i kapërcejë gjërat e veta personale, sepse.... Të mendojmë se 37 akademikë të nderuar janë pro këtij projektligji, çfarë ndryshon?! Unë mendoj se duhet të diskutoni argumentet dhe jo njerëzit, sepse po të jetë kështu, edhe unë mund të thërras 200 profesorë... Çfarë do të bëjmë ne, do të luajmë me numra, sepse logjika e politikës kjo është: unë kam kaq vota, ti ke kaq vota, por unë mendoj se ne po gjuajmë nga pikëpamja shkencore dhe kur vijmë këtu jemi para ligjvënësit, i cili thotë: “Ata 37 akademikë të nderuar, që unë i respektoj....” A mund t’ju pyes diçka?! Ata akademikë a kanë dhënë ndonjë argument në ndihmë të dy deputetëve apo tuajin?! Nëse kanë dhënë ndonjë argument, edhe një po të ishte.... 37 akademikë pa asnjë argument, unë nuk e di?! Pastaj, ata janë 237, por kjo nuk ndryshon asgjë për mua. Nga kjo pikëpamje, për mua, nuk ka asnjë vlerë, por,

nëse vijmë te logjika e peticioneve të mbështetjes së masës ndaj kësaj apo asaj, unë nuk dua të hyj këtu, unë dua të qëndroj vetëm tek etika e filozofisë së ligjit, epistemologjisë së shkencës, e shkencës, e drejtimit të institucioneve shkencore e të tjerë. Çdo dalje përtej kësaj, mua nuk më ka hije dhe nuk më takon ta bëj këtu. Po të bëjmë debate, është diçka tjetër pastaj, por unë respektoj vendin ku jam dhe personat që kam përballë.

Zonja Zhupa, kam edhe diçka tjetër. Në qoftë se do të kishte qenë ky konsultim, do të kishte qenë ky mendim, unë mendoj se zotërinjtë deputetë do ta kishin relatuar. Unë i besoj relacionit,. Në relacion a ka ndonjë mendim të Akademisë për këtë gjë?! Unë e kuptoj pse s'ka, sepse Kryesia nuk mundet të vijë e të thotë: “Ne kërkojmë që të marrim mandatet dy herë radhazi dhe kryetari të thotë që edhe pas 75 vjetëve një kryetar mund të rrijë në detyrë:, kjo do të ishte konflikt interesi. Unë e kuptoj psikologjikisht këtë ngërç dhe jam gati ta pranoj, por për mua kjo gjë ka rëndësi po të qëndrojë në logjikën juridike: a është në relacionin e paraqitur nga zotërinjtë deputetë ky mendim i Akademisë së Shkencave? A kanë dhënë argumente?! Nuk kanë dhënë! Atëherë, për mua nuk vlen.

**Flutura Aça** - Zoti Fuga, faleminderit shumë!

Zonja Gjylameti, fjala për ju.

**Blerina Gjylameti** - Profesor Fuga, dua t'ju lutem edhe një herë, për të qenë të qartë për mënyrën se si funksionon njoftimi. Ju si i merrni njoftimet për mbledhjen e Asamblesë, sepse, realisht, deri tani diskutuam që nuk keni marrë njoftim? Pra, dua të di procedurën si e merrni njoftimin, a ka një sekretari që ju njofton, apo email, sepse për mua është shumë i rëndë fakti që të mos jeni njoftuar, prandaj ju pyes se çfarë procedure ka Asambleja kur ju njoftoheni për mbledhje apo edhe për të dhënë mendim për çështje të caktuara?

I dëgjova me shumë vëmendje të gjitha argumentet tuaja, unë e kam parim që nuk merrem dhe nuk do të doja kurrë që një projektligj, një ndryshim ligjor të merret me një emër, sepse po arritëm aty që çdo gjë të jetë për një emër, kjo është gjëja më e gabuar e mundshme, por, ndërkohë, në anën tjetër, demokracia është edhe me numra. Ju thatë që numrat i respektoni, por nuk kanë vlerë për sa kohë nuk japin argumente, por unë mendoj se demokracia është edhe me numra. Për të dyja koleget e mia, dua t'ju them se nuk janë 37 firma që nuk dimë kush janë, sepse Asambleja ka 52 anëtarë, në mos qofsha e gabuar, por edhe mund të jem, dhe këtu janë 37 anëtarë të nderuar që kanë firmosur dhe kanë dhënë dakordësi, ndërkohë, janë 14 që kanë shprehur dakordësi, por nuk kanë firmosur, kemi 1 anëtar, i cili ka marrë dijëni, siç është zoti Kadare, por që nuk është



shprehur, 1 anëtar, që ju e përmendët pak më parë, zoti Apollon Baçe, profesori, i cili ka abstenuar, dhe 2 anëtarë, të cilët nuk janë shprehur institucionalisht, që është zonja Anastasi dhe ju. Kështu që, demokracia me numra është, ndërkohë, unë, në cilësinë e relatores, së bashku me zonjën Zhupa, patjetër që do të shikojmë për çfarë ju thatë se si dhe si qëndrojnë, por edhe këtu dua t'ju kundërshtoj atë që thatë pak më parë, që i respektoni, por që ligjvënësi nuk duhet të shikojë vetëm te numri i shprehjes. Për sa kohë që Asambleja ka 52 anëtarë, të cilët shprehin dakordësi, kjo do të thotë që ka diçka që qëndron. Unë dua t'i respektoj maksimalisht të gjithë ata që shprehin një mendim, qoftë edhe po të ishte kundër kësaj nisme të kolegëve të mi; edhe juve ju respektoj për çfarë thatë deri më parë.

Faleminderit!

**Flutura Aça-** Faleminderit, zonja Gjylameti!

Dua të bëj një shpjegim lidhur me atë që unë thashë. Zonja Gjylameti, unë nuk i rashë mohut të firmave, nuk thashë gjë, nuk i diskutova firmat, fare, por fola për faktin dhe për mënyrën se si i është servitur firmave. Këtë kisha problem, jo firmat, ato nuk i vura fare në dyshim.

Zoti Fuga, fjala për ju.

**Artan Fuga** - Faleminderit!

Larg meje të formuloj shprehje që çdo student i vitit të parë, i cili do të vinte dhe të thoshte që demokracia nuk ka lidhje me numrat, unë të mos e ngelja në klasë....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A mund të vazhdoj, ju lutem?

**Blerina Gjylameti** - Po.

**Artan Fuga** - Faleminderit!

Unë nuk e thashë një gjë të tillë, që demokracia nuk ka lidhje me numrat. E thashë edhe më parë që gjithë ditën mësoj se sa i rëndësishëm është numri në demokraci.

Po i përgjigjem pyetjes së parë, në mënyrë që të jem i saktë fare me ju, zonja deputete. Ne njoftohemi me email dhe, që të jem i saktë, unë nuk kam marrë email, nëse ata e kanë dërguar, unë këtë nuk e di. Kjo gjë nuk ka pikën e rëndësisë, por për të ishte për të diskutuar (nuk jam unë që mund të gjykoj), do të kisha dashur që nga ata 35 apo 37 akademikë, që sapo e përsërita, të cilët janë shumë të nderuar, unë nuk paragjykoj asnjë person, shkruaj vetëm nga pikëpamja e logjikës së ligjit, tre nga ata të vinin, por nuk duan, kjo është me dëshirë.

Çështja e numrit dhe e demokracisë, po ta trajtojmë siç duhet dhe me korrektesë, unë i qëndroj Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit dhe kompetencave të deputetit. Një deputet merr iniciativën ligjore (ju i dini më mirë se unë këto gjëra, por po i them, sepse më pyetët) dhe shikon që nga grupet e interesit mundet që në një agjenci të ketë një pakicë, një shumicë. Shumica që krijohet në agjenci nuk ka të bëjë me vendimmarrjen e deputetit, nuk i lidh duart deputeti nga ajo shumicë që është krijuar atje, por, sigurisht, deputeti mban parasysht.

Dihet që unë jam vetëm, nuk ka nevojë për shkresa. Unë e kam deklaruar që brenda Akademisë unë jam vetëm, në këtë pozicion të shprehur publikisht. Nuk është fjala nëse në Asamble do të merrej një vendim, sepse Asambleja funksionon me vendime. Unë po ju pyes: a është bërë mbledhja e Asamblesë për të marrë atë vendim?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, një minutë. Unë nuk e kam parë, di vetëm që një asamble ishte për t'u mbledhur dhe për të votuar, demokracia kërkon: shumica vendos, dhe thuhet: "99,99% janë dakord, vetëm një njeri nuk është dakord". Jepeni këtë përfundimin dhe unë them që demokracia funksionon me numra. Mendimi i Akademisë nuk është mendimi i Artanit, por është mendimi i këtyre të tjerëve dhe nuk ka nevojë të prodhohen ato shkresa. Unë e deklaroj, e kam deklaruar, vazhdoj ta deklaroj, madje e ka për nder, që jam vetëm dhe, mendimin tim, fatmirësisht, ky shtet, ky Kuvend, kjo demokraci, ashtu siç është, e lejon këtë gjë. Po të ishte puna sipas asaj demokracie, unë në vitin 2019 nuk do ta kisha ngritur zërin, nuk do të shqetësohej qeveria, nuk do të shqetësoheshin deputetët dhe të thoshin: "Çfarë është ky Artani, një është, këta janë 40 të tjerë", por ja që kështu ka funksionuar. Unë nuk dua të hyjë në historinë e shkencës që në shkencë nuk ka shumicë-pakicë, por ka në votime, si funksionon demokracia në institucione të brendshme.

A ka ndonjë argument që të përfitojmë dhe të tërhiqem edhe unë?! A kanë avancuar në ndonjë argument, sepse mund t'i ndihmonte edhe zotërinjtë deputetë, edhe mua. Unë jam gati sot të tërhiqem nëse më japin një argument që idetë e mia janë të mbrapshta apo të ndërtuara mbi një interes personal.

Faleminderit!

**Flutura Açka-** Zoti Fuga, faleminderit!

Fjalën e kanë zoti Beqiraj dhe zoti Nasufi. Pyetjet mund t'i bëni në bllok, nëse keni pak pyetje.

**Ismet Beqiraj** - Zoti Fuga, ju përshëndeta edhe në fillim, por po ju përshëndes edhe *live*.

Sigurisht që unë e kam shprehur afeksionin dhe respektin që kam për botën akademike, sepse i përkas asaj bote. Vitet e fundit të jetës time aktive jam Profesor i Asociauar, Doktor i shkencave kimike në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, dega Kimi Industriale. Dua që ta dish edhe *backgroundin* edhe të ne deputetëve, ku unë nuk do të ndalem te prononcimet publike, që, me thënë të vërtetën, i kuptoj, njerëz jemi, diku edhe jemi paragjykuar, si, për shembull, çfarë duam ne të merremi me botën akademike. Po, detyra e deputetit dhe puna e tij është jo vetëm të ngrejë dorën, duke respektuar vullnetin politik të grupit që i përket, familjes së tij politike, por edhe të bëjë nisma deputeti. Sigurisht, asnjë nismë, qoftë për një ligj të ri, qoftë edhe për këtë projektligj, i cili është kthyer në një debat publik, asgjë nuk është e përkryer, është relative, asnjëherë nuk mund të tentojmë që një gjë e çojmë deri në fund dhe nuk ka ndryshime. Asgjë nuk është e shkruar në gur dhe nuk ndryshon; ndryshon, sepse jeta zhvillohet nëpërmjet zhvillimit dhe ndryshimit. Këtë e kisha në parantezë. Unë kam respekt, edhe pse jam i shkencave ekzakste, e kam ndjekur dhe lexuar penën tuaj me endje dhe ju vlerësoj. Ndaj, ju lutem, edhe ndaj figurës së deputetit, do ju lutesha që shembullin e parë ta bëjmë ne, që jemi njerëzit e mendjes dhe akademikët! Të mos e baltosim edhe kur gabojmë, por jo kur bëjmë faj, sepse njerëz jemi, gabimi është njerëzor.

Më tërhoqi diçka vëmendje, nuk kisha nder mend ta bëja dhe nuk doja t'u ndalesha gjatë në letrat tuaja, të cilat i kam lexuar dhe studiuar me laps në dorë, ashtu siç mund të na edukonit ju, sepse nga mosha duhet të më jepje leksione në universitet, dhe të jesh i sigurt që në personalitetin tim unë mbetem ai i 4 vjetëve, që thua: “E ke mbrojtur me shumë fanatizëm”...

**Flutura Açka** - Zoti Beqiraj, ju lutem, kalojmë te pyetjet. Zoti Beqiraj, jo në gjëra personale, të kalojmë te pyetjet, ju lutem!

**Ismet Beqiraj**- Media publike është në komision, jam i regjistruar dhe i dinë ligjëratat e mia këtu. Misioni im si pedagog në universitet është, e kam thënë edhe herë tjetër: të bie shkencën në politikë dhe jo të çoj politikën në shkencë. Ky është misioni im.

“Me një lule nuk vjen behari”, thotë populli, ndaj, le të bashkohen shumë lule.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, mos paragjykoni!

Çdo nismë deputeti duhet lavdëruar dhe nxitur. Le të korrigjohet me debat dëgjesa publike...

**Flutura Aça-** Zoti Beqiraj, këto nuk janë çështje që duhet t'i diskutojmë me zotin Fuga. Këto janë çështje ndërmjet nesh kur të largohet zoti Fuga, ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ina, kur ta zëvendësosh zonjën, por, tani për tani, nuk e zëvendëson, mos ki merak.

Nuk kisha nder mend të ndalesha, por po ndalem te një letër që i është drejtuar edhe institucioneve qendrore, duke filluar nga Kryetarja e Kuvendit, ku thoni, dhe sapo e thatë që nuk keni një qëllim në vetvete për të gjithë këtë aksion që po merrni, por mua më rezulton ndryshe, prandaj po lexoj paragrafin e dytë që i është drejtuar këtyre institucioneve: “Ju drejtohem me këtë letër publike si qytetar i Republikës të Shqipërisë, Profesor dhe anëtar i Akademisë të Shkencave, gjithashtu, si i deklaruar publikisht me synimin për të qenë ndoshta kandidat për vendin e punës “Kryetar i Akademisë së Shkencave të Republikës të Shqipërisë”.

**Artan Fuga** - E përsëris prapë.

**Ismet Beqiraj-** Kjo ishte pyetja që doja të bëja, të cilën nuk kisha nder mend ta bëja, që ju sapo e thatë që nuk keni qëllim në vetvete, por keni synim që të kandidoni, shumë mirë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, mos bëni gjykatësen, vazhdoni e bëni prokuroren!

Pyetja e dytë lidhet me atë që thatë që në fillim të fjalës suaj: “Dhe unë po e lidh lidhur me rolin dhe funksionet kryesore të Akademisë së Shkencave që do të marrin, ose dublojnë institucione të tjera”, por te neni 4 i ligjit ekzistues në fuqi thuhet: “Të pranojë të kontribuojë, të ndërtojë, të këshillojë, të nxisë, të promovojë, të botojë, të bashkëpunoj e të tjera”, por nuk thatë asgjë urdhëruese, pra, në termin urdhërues, si “Unë do të bëj këtë, ti do bësh këtë, unë jam ai, ti je ajo” dhe qartësohet që nga pika 1 të inkurajojë, të orientojë, të propozojë, të ruajë deri te pika 19, por mua më rezulton ndryshe, sepse është me ligj që në qoftë se merr kompetenca jashtë këtij neni të këtij ligji, është në kundërshtim me ligjin dhe nuk ia jep njeri këtë të drejtë, sepse nuk e ka.

Pyetja e tretë lidhet me rotacionin fals, që janë zgjedhjet, neni 11, tek e fundit, është edhe vetë neni 3 që debatohet. Sigurisht ju e keni parë draftin, edhe ne gjatë shqyrtimit do të shprehim argumentet përkatëse pse jemi mbështetur, por edhe statuti i Akademisë së Shkencave angazhon gati 8 nene se si bëhet kjo procedurë dhe unë nuk do të ndalem këtu. Ku qëndron rotacioni fals, kur zgjedhja është e lirë, është e hapur, nuk ka trysni dhe intimidim ndaj asnjë personaliteti, sepse nuk do të guxojë njeri ta bëjë këtë punë? Ky nen ekzistues, por edhe ndryshimet që bëhen, tek e fundit, bashkojnë dy dispozita që kanë të njëjtin thelb me ligjin ekzistues, ku, sigurisht, është edhe

heqja e fjalës “dhe jo radhës”. Ne kemi propozime, argumente, ndaj bëhen edhe dëgjesat, edhe diskutimet e gjëra dhe, në fund, është Kuvendi që do të marrë një vendim.

Në lidhje me statutin e akademikut mbi moshën 75 vjeç, zoti Fuga, a e dini që ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese për këtë gjë? Vendimi nr. 36 dt. 15.10.2007, thotë: “Shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të frazës “pa të drejtë vote”, në nenin 8 të ligjit nr. 9655 dt. 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”. Sigurisht që ky ligj është i shfuqizuar, por Gjykata Kushtetuese e shfuqizon si të papajtueshëm me Kushtetutën këtë vendim dhe, besoj se ju e dini për çfarë bëhet fjalë.

Kur një grup deputetësh kanë kërkuar amendimet e disa dispozitave ligjore të këtij ligji të vitit 2006, neni 8 ka të bëjë me faktin që akademikët mbi moshën 75 vjeç u mohohet e drejta e votës, që ka të bëjë me të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në organet drejtuese të Akademisë së Shkencave. Ne kemi në dorë një vendim të Gjykatës Kushtetuese, i cili nuk është shfuqizuar. Si sot 4 vjet më parë ne kemi bërë dëgjesën me ju dhe, për kulturë, për të qenë koherent me ato që do të thosha dhe me ato që do të ballafaqohesha me ju, në respektin tuaj, në arkivat e Kuvendit kam lexuar procesverbalin e mbledhjes së asaj dite suaj dhe, në mbledhjen e fundit të 5 nëntorit të vitit 2018, të cilin e kam lexuar, ju keni qenë kundër mbajtjes së titullit “akademik”, pra, akademikët që kanë mbushur moshën 75 vjeç, ku ju e kishit mendimin më të avancuar dhe thoshit që ta fillonit që në moshën 68 vjeç.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Qofsha unë i gabuar.

**Flutura Açka** - Zoti Beqiraj, ju lutem pyetje jo debate!

**Ismet Beqiraj**- Në lidhje me dakordësimin e afateve të Asamblesë, që ju nuk jeni njohur kurrë me të, e konsumuan koleget e mia dhe nuk po ndalem.

Meqenëse bëhet një debati i madh që do të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë akademikët mbi moshën 75 vjeç, dua të bëj një pyetje direkt dhe është mirë ta lexoni këtu: a e keni lexuar se çfarë thotë neni 9 i ligjit ekzistues, pika 10, për anëtarët emeritus?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, nuk jeni avokate, nuk ka profesori i nderuar të mbrohet, ai i mbron të tjerët, jo ty e mua.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Lëreni tani. Ju thatë: “Ku i morën deputetët këto informacione?” dhe unë do t’ju pyes: në nenin 22, marrëdhëniet me institucionet shtetërore dialogu shkencë-politikë kur ne marrim pjesë dhe, sigurisht, kur marrim pjesë marrim edhe materialet e analizave vjetore të veprimtarisë së Akademisë së Shkencave. Akademia e Shkencave thirret në dëgjuesë edhe për këtë punë, por kjo nuk na e privon të drejtën neve si deputetë, bazuar edhe në ligjin për kërkimin e informacioneve t’i drejtohem Asamblesë, t’i drejtohem kryesisë.

Së fundi, dua t’ju bëj një pyetje, profesor: titujt akademikë fitohen apo jepen?

Faleminderit!

**Flutura Açka-** Zoti Beqiraj, faleminderit!

Zoti Fuga fjala për ju.

**Ina Zhupa-** A mund ta marr fjalën për procedurë?

**Flutura Açka-** Po, zonja Zhupa, por sa më shkurt, sepse ka zoti Nasufi diçka.

**Ina Zhupa-** Për rekord të mbledhjes, zoti Beqiraj është propozuesi i projektligjit dhe në traditën e komisionit propozuesi i projektligjit merr pyetje dhe përgjigjet, nuk është propozuesi i projektligjit që i bën pyetje atij që ka ardhur për të dhënë argumente. Zotëria duhet të kthente përgjigje për argumentet që dha zoti Fuga, i cili argumentoi plot 6 shkelje ligjore, shkelje kushtetuese, shkelje të Rregullores, dhe pyetjet që vijnë janë: “A ke ti ambicie apo nuk ke ti ambicie?”. Sikur jemi në kohën e komunizmit këtu që duhet t’i gjykojmë njerëzit a kanë ambicie për karrierë dhe a është e gabuar karriera. Në rast se do të vazhdojmë kështu me komisionin, ne jemi komplet jashtë rendit të ditës dhe jemi komplet jashtë procedurës parlamentare siç është dhe projektligji i zotërisë.

**Flutura Açka-** Zonja Zhupa, faleminderit!

Besoj se zoti Beqiraj i ka mbajtur shënim të gjitha pyetjet që ka pasur zoti Fuga dhe gjatë raportimi të tij në mbledhjen për të diskutuar, besoj se do të japë përgjigje.

Zoti Fuga, fjala për ju.

**Artan Fuga-** Faleminderit shumë, zoti Beqiraj!

Unë nuk e di nëse është në procedurën tuaj apo jo, por unë jam një njeri që punoj në fushën e komunikimit dhe, jashtë procedurave, çdo lloj pyetjeje e konsideroj si respekt, personalisht për mua nuk ka asnjë problem, ndërsa për komisionin i dini ju.

Me thënë të drejtën te pyetjet tuaja ndjeva një lloj presioni që më bëni, por nuk ka problem, edhe presioni është i mirë, sepse, në fund të fundit, hapësira publike nuk është një katedër ku mund

të ligjërosh qetë, sepse ju më thoni që të kem respekt për deputeti. A keni ju ndonjë deklaratë timen publike, ku unë them se zoti Ismet Beqiraj nuk merr vesh nga kjo punë? Në qoftë se ju keni ndonjë deklaratë publike, dakord, por në qoftë se dikush mund t'ju ketë thënë diçka, kjo del jashtë gjësë sime. Dua t'ju them diçka: kur më kritikojnë në mjediset publike për profesionin tim të profesorit dhe akademikut, nuk mërzitem fare, nuk e marr për fyerje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord, por e ngritët këtë problem dhe unë po ju them: a keni ju një deklaratë? Pse ma bëni këtë gjë? Nëse kam bërë një deklaratë të tillë, ma thoni dhe të mbaroj punë e të kërkoj falje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Përderisa ju e thatë.... Nëse ka një deklaratë të tillë, ma thoni dhe t'ju kërkoj falje. Edhe sikur ta kem shkelur pak apo shumë, nuk ka lidhje me argumentet e mia. Prandaj, unë jam këtu për t'ju thënë: ju lutem qëndrojmë tek argumentet! Unë nuk po u bëj gjyq intensiononi dhe gjyq qëllimesh as Akademisë, as kryetarit, as akademikëve të tjerë. A janë ata bashkë në unitet me njeri-tjetrin?! Po! Respekt! Unë kam mendimet e mia. Unë po vij me besim te ju, sepse po të mos kisha besim, unë do të thosha që një institucion është kundër meje, rri Artan dhe mbaroje atë punë, por mua më ka mësuar historia që nuk ndodh kështu. Prandaj, për atë që thoni për respektin, respektin e kam të plotë, nëse keni ndonjë konstatim, ju lutem, ma thoni!

Ju i referoheni një letreje time publike dhe thoni: “Ju atje keni shpallur dëshirën për të parë mundësinë kandidimit”. Zoti Beqiraj, një konflikt interesi bëhet kur është i rregulluar me ligj, sepse po të jetë puna që s’do të kishte të bënte me statusin ligjor, çdonjëri nga do të paragjykohej dhe do të futemi në një logjikë, që nuk është kjo e shoqërisë ku ne jetojmë. Nëse unë kam kandiduar dhe nga pikëpamja ligjore jam në kushtet e kandidimit, mund të ma thoni, por mos thuaj që nuk është konflikt interesi, sepse keni konflikt interesi, ashtu sikurse unë, megjithëse kam të drejtë ta them, nuk e them, nuk e kam thënë deri tani dhe nuk do ta them që anëtarët e kryesisë, të cilët kanë firmosur atje, janë në konflikt interesi, sepse bëhet fjalë për ta. Unë nuk e them këtë, sepse gjykoj argumentet. Unë prisja nga ju që të thoshit: “Po ata të pestët atje a nuk janë në konflikt interesi?”, por ju këtë nuk e thoni, ju e keni problemin me mua, ju faleminderit, nuk ka asnjë problem!

Kalojmë te problemi. Si e kuptoj unë kandidimin për kryetar të Akademisë së Shkencave?! Nuk e konsideroj si një gjë personale, sikurse ju që nuk besoj se postin e deputetit e konsideroni si një çështje tuajën personale. Unë e konsideroj si një detyrim, si një detyrë, si një gjë për t'i

shërbyer, jo për interesat e mia personale, interesa personale nuk kam asnjë, edhe po të kandidoj për kryetar të Akademisë së Shkencave, dhe do të kandidoj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Urimet kur të zgjidhem.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

*Lajmin e dhatë ju.*

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A mund ta vazhdoj? Nuk ju ndërpreva.

Ju përmendni një letër, të cilën e kam bërë publike. Zoti Beqiraj, të mos kthehemi mbrapa, të mos ngatërrojmë deponimin, dëshminë, apo referimin tim në komision me letra publike. Ju lutem, të vlerësojmë, dhe unë vlerësoj, statusin e çdo teksti! Unë këtu, edhe çfarëdolloj gjëje të kem thënë atje, sot jam këtu me këtë tekst para jush dhe, ju lutem, gjykoni këtë tekst, përndryshe do të filloni të merrni çdo lloj teksti tim dhe të thoni: “Keni thënë kështu, keni thënë ashtu”.

Ju pyesni: “Ku e di unë që do të bëhet rotacion farsë?”. Zoti Beqiraj, ju lutem, ka një keqkuptim, unë ju kam thënë që 4 vjet përpara kam deklaruar se këtu rotacioni po bëhet farsë, kryetari po bëhet zëvendëskryetar, zëvendëskryetari po bëhet kryetar dhe këtë koncept e mori zoti Rama dhe e përdori. Unë nuk po them se si do të bëhet, sepse shkencërisht mua nuk më lejohet të predikoj dhe unë ia kursej vetes këtë gabim, që po të ma bënte një student, do t’i thosha: “Mos e bëj!”, unë po them për 4 vjet më parë. Në qoftë se nuk ka qenë rotacion farsë, unë ju pyes: pse u bënë të gjithë ato gjëra? Ky është sqarimi që unë kam për pyetjen tuaj.

Kalojmë te një problem tjetër, te vendimi i Gjykatës Kushtetuese, që autorizon akademikët e nderuar mbi 75 vjeç të kenë të drejtën e votës. A them unë ndonjë gjë në tekstin tim që atyre duhet t’u hiqet e drejta e votës?! Ju thoni se dikur kam qenë në një mbledhje, ku unë kam thënë që t’u hiqen edhe titujt, por unë ju them që e keni gabim. Edhe sikur ta kem thënë këtë, çfarë lidhjeje ka kjo me pozicionin tim dhe argumentet e mia sot, ku nuk shkruhet asgjë që t’u hiqet e drejta e votës?! Po të doni ju, unë mund t’ju them një gjë: unë e konsideroj të turpshme që ata të trajtohen në atë mënyrë, pra që ata të vijnë të japin votën, por që nuk kanë të drejtë të zgjidhen. Kjo është, për mua, një zhbalancim i jashtëzakonshëm midis të drejtës dhe detyrimit, nëse e doni. Kjo do të thotë: “Hajdeni jepe votën, ti mund të zgjedhësh, por ti mund të mos zgjidhesh”. A dini ju ndonjë rast ku ky zhbalancim....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*



**Flutura Aça-** Ju lutem, mos ktheni përgjigje!

**Artan Fuga-** Ju nuk keni asnjë propozim të tillë. Ju lutem, mos ngatërroni opinionin publiko, sepse nuk është mirë. Nuk keni asnjë propozim të tillë, ju lutem! Pyetjes: titujt jepen apo fitohen, unë në provim jam këtu?! Çfarë lidhjeje ka kjo me prezantimin tim?! Unë mund të përgjigjem, por nuk e gjej të arsyeshme të përgjigjem, sepse nuk ka lidhje me përgjegjësitë e mia.

Ju faleminderit!

**Flutura Aça-** Zoti Fuga, faleminderit!

Fjalën e ka zoti Nasufi, pastaj zoti Koçi dhe zoti Metaj.

Vetëm pyetje, ju lutem!

**Fadil Nasufi-** Faleminderit, profesor Fuga!

Në fakt, ky debat po zgjatet pak. Unë ju vlerësoj si një zë i fuqishëm mediatik dhe prezent në jetën publike, në fushën e komunikimit dhënë fushën ku ju ushtroni profesionin, por edhe për ligjin për Akademinë e Shkencave, ku ju keni qenë aktiv dhe keni paraqitur një paltformë para 4 vjetësh. Me sa mbaj mend, unë kam qenë anëtar i përhershëm i këtij komisioni dhe e kemi kaluar në datën 18 korrik të vitit 2019. Ne kemi pasur një kalendar shumë intensiv me konsulta, pyetje, dëgjesa, dakordësi, kundërshtime, modele dhe qasje. Nuk është lënë asnjë aktor pa u ftuar në këtë komision për të mbrojtur ligjin aktual të Akademisë së Shkencave.

Realisht pamë dy qasje: një qasje të modeleve shumë të mira europiane, por pse jo edhe të Kosovës, dhe një qasje me shije të hidhur të ish- ligjit të Akademisë së Shkencave, që pothuajse e kishte kthyer pas. Pra, ky ishte një ligj i dakordësuar në shumicë, kurse platforma juaj që erdhi këtu përpara 4 vjetësh ka një kundërthënie. Përpara 4 vjetësh ju ishit kundër faktit që ligji lejonte vetëm një mandat të kryesisë, kurse tani mendoni të kundërtën, që mos të ketë dy mandate, edhe me argumentin që kryetari të zgjidhej nënkryetar dhe bëhej ky rrotacioni i përhershëm që ndodhte në procedurë.

Sot ju folët pothuajse negativisht për këtë bilanc 4-vjeçar të Akademisë së Shkencave. Çfarë ka ndryshuar për mirë nga ligji i ri që kemi miratuar dhe nga kjo trupë drejtuese e Akademisë së Shkencave?

Platforma juaj është diskutuar ndonjëherë në Asamblenë e Akademisë apo thjesht ka ardhur në Komisionin e Medias, ku më shumë bëhet një debat politik?

Për sa i përket çështjes së mandateve, ne kemi miratuar edhe ligjin e arsimit të lartë, ku mandati i rektorëve është me të drejtë zgjedhjeje deri në dy herë. Po Akademia, si pjesë e trupës

që ka edhe jetën universitare, pse mos ta ketë këtë të drejtë? Për t'iu referuar historisë, ne kemi pasur edhe kryetarë me dy mandate, siç ka qenë rasti i Muzafer Korkutit apo i Teki Biçokut, të cilët, me statusin “akademik të përhershëm” e kanë pasur të drejtën e ushtrimit të zgjedhjes dy herë në drejtimin e Akademisë së Shkencave.

Zonja Gjylameti bëri një pyetje, por këto ndryshime të amendamenteve kanë kaluar në asamble me vendimin nr. 50 të shtatorit 2022 me atë raport votash që argumentoi. Pra, ka një konvergjim dhe korrektesë procedurale edhe nga Asambleja e Akademisë, e cila ka kaluar këto ndryshime, sepse tani janë duke i parë gjërat nga brenda. Kjo trupë që erdhi me ligjin e vitit 2019 po e shikon çfarë duhet të ndryshohet dhe freskohet brenda një sistemi administrativ dhe të hierarkisë që kryen Akademia e Shkencave.

Për të drejtën e moshës, me sa shikoj unë nga një statistikë, nëse do të heqim kufizimin e moshës 75 vjeç, u lind e drejta gati 20 akademikëve. Kufizimet që bëhen në ligj për njerëzit e dalluar më duket qasje e gabuar, sepse duhet të kemi sa më pak barriera në afrimin e njerëzve, pavarësisht hierarkisë së zgjedhjeve apo po të kontributeve që japin në këtë asamble.

Në mbyllje të këtyre pyetjeve dhe këtij komenti që bëra, përsëri unë ju vlerësoj për këtë konstante, sepse bën mirë, opozicion dhe frymë kritike, por, gjithsesi, duhet të shkojmë te koherenca e një vullneti, që në fund fare përcaktohet me votë brenda një asambleje, që e përcakton ligji për Akademinë e Shkencave.

Faleminderit!

**Flutura Açka** – Faleminderit, zoti Nasufi!

Po, zoti Fuga. Më pas e ka radhën zoti Koçi.

**Artan Fuga** – Zoti Nasufi, faleminderit për komentet që bëtë!

Ju mund të mos më vlerësoni. Domethënë, unë ju falenderoj që më vlerësoni, por edhe nëse nuk do të më vlerësoni, unë kam disa sjellë disa argumente! Ju thoni se më vlerësoni për opozicionin, por edhe mund t'ju them juve të njëjtën gjë. Edhe unë ju vlerësoj për të gjithë argumentimin që bëni kundër opozicionit tim, por mund të kem edhe unë ndonjë lutje për ju: Më dëgjo edhe mua ndonjëherë!

Pra, kjo është një çështje etike, që duhet ta kursejmë, sepse na pengon për të hyrë në thelb. Respekti është reciprok, por unë nuk jam mësuar të më vlerësojnë në sy. Prandaj, ju lutem, kursejeni këtë gjë! Pra, respekti është reciprok edhe për arsye të tjera që e shtojnë këtë respekt.

Unë ju lutem për një gjë: mos më vini në gojë fjalë, të cilat unë nuk i them kurrë dhe nuk i bëj ato gabime! Ju thatë: “patët negativitet ndaj arritjeve të Akademisë”. Gjejeni ku e kam thënë? Gjejeni nëse e kam shkruar? Mendoni ju se unë mund të kem atë kokëfryrje sa unë si individ të vij dhe të them nëpër rrugë se këto arritje të kolegëve të mi nuk janë pozitive? Jo, zoti Nasufi, nuk i bëj unë ato gjëra. Prandaj, ju lutem, tërhiqeni atë që thatë!

Për sa i përket pyetjes nëse ka gjëra pozitive në Akademi, në nuk ju përgjigjem për këtë pyetje, sepse nuk ka lidhje me këtë që po them unë. Nëse doni t’i përgjigjem, unë i jam përgjigjur në mënyrë ligjore duke thënë: “Kur zotërinjtë deputetë që kanë bërë këtë nismë juridike thonë që ka këto arritje pozitive, pse duhet të ndryshojmë ligjin?” Pse e bëj këtë pyetje? E bëj sepse e kërkon norma procedurale. Pra, ti do të ndryshosh një normë në fuqi në qoftë se ajo nuk lejon përmirësimet që bëhen. Kur të gjitha janë pozitive, bini në kundërshtim me nenin 2, germa “b”, të Rregullores. Prandaj, ju lutem, mos ma thoni mua këtë gjë, sepse nuk më vjen mirë dhe dashur pa dashur më çon në një marrëdhënie jo të mirë me kolegët e mi, të cilën unë nuk e pranoj dhe prandaj jam shumë i ndjeshëm për këtë gjë.

Ju thatë se në platformën time 4 vjet më parë unë isha kundër për një mandat. Ju lutem, gjejeni ku e kam thënë, zoti Nasufi! Mos të flasim në ajër, që opinionin publik ta marrë si të mirëqenë. Ja dhe e gjetët dhe unë e paskam thënë. Çfarë ndryshimi sjell kjo? Ju bini në kundërshtim me atë që thotë zoti Beqiraj. 4 vjet më parë, zoti Beqiraj dhe ju personalisht, e keni quajtur këtë ligj shumë të mirë. A ju thashë unë ju, zoti Nasufi, pse kërkonte të ndryshoni një ligj që 4 vjet më parë e keni votuar? Keni të drejtën e ndryshimit, zoti deputet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Hajde të diskutojmë këtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një minutë, pra. T’i marrim me radhë, sepse në fund keni thënë një gjë shumë të rëndësishme dhe unë jua di për nder që e thatë atë gjë.

Vjen puna te disa kryetarë të Akademisë, të cilët kanë qenë mbi 75 vjeç. Zoti Nasufi, një fakt ka kuptim brenda një strukture ligjore. Hiqe strukturën ligjore dhe nuk është më fakt. Pra, si ta shpjegoj unë këtë? Ata ishin mbi 75 vjeç, 80 vjeç apo 85 vjeç, por ishin brenda një strukture ligjore që fliste për akademikë të përhershëm, që në relacionin e kolegëve tuaj thuhet se u bë mirë që u hoq. Pra, ata ishin në ato kushte. Për shkak se ata ishin në ato kushte, nuk mund të jemi edhe sot, sepse nuk veprohet kështu juridikisht. Unë këtë po them.

Ju më pyesni nëse argumentet e mia i kam shprehur në Akademinë e Shkencave. Zoti Nasufi, me çfarë të drejte më hiqni të drejtat e mia qytetare? A keni ju ndonjë të dhënë që këto propozime nuk janë të zotit Koçi dhe të zotit Beqiraj, por janë të Akademisë së Shkencave? Keni ndonjë gjë të shkruar? Po ta kishit të shkruar, unë do të thosha se jam kundër, siç edhe e kam bërë. Shkoni interesohuni! Do të thosha: “- Me leje? - Po. - Unë jam kundër. - Je kundër? - Po. - Pusho! Je një person. Votojmë. Mbyllet votimi.” Kaq është. Siç kam bërë gjithmonë, siç kam bërë për 4 vjet. Kam thënë: “Unë jam kundër. - Je kundër? Punë e madhe.”

Për një gjë që e ngrini ju, unë, në respektin tuaj, vij ju përgjigjem këtu, kurse ju më thoni shko përgjigju atje. Pse? Për çfarë arsyes? Kolegët e mi nuk vijnë këtu, kurse unë kam ardhur këtu që ata të ishin këtu dhe t’ua thosha në sy. Këto probleme unë i kam thënë edhe publikisht, jo nëpër korridore, siç mund t’i thotë iksi dhe ipsiloni, por kjo është histori tjetër.

Ndërkohë që unë pres të vijnë kolegët, në sekondën e fundit më vjen një letër me 35 firma. Çfarë të diskutoj më unë? Çfarë kërkoni më nga unë?

Prandaj, ju lutem shumë, mos ngrini këto probleme? Unë kam ardhur këtu, sepse ju keni shtruar problemin. Unë nuk kam ardhur se zonja Nikolla ka dashur që unë të vij, se edhe sikur të donte ajo, nuk vija unë, por ajo ka thënë: Mbi bazën e kërkesës që ke bërë, ke të drejtën të vish në këtë pikë. Unë kam ardhur në emër të Rregullores. Nuk ja di për nder askujt.

Ju thatë: “Ju nuk jeni dakord me kufizimin e moshës 75 vjeç”. Unë këtu ju jap absolutisht të drejtë, sepse ka njerëz që në moshën 75 vjeç mund të jenë në pjekuri të kërkimit shkencor, të logjikës shkencore, e me radhë. Po të shikosh çfarë kam thënë unë 4 vjet më parë, unë i kam thënë gjërat, por në refuzimin që më bëhej nuk pranohej as nuanca. E di çfarë po thoni, zoti Nasufi? Po thoni që nëse doni të rregullohen këto amendamente që kanë ngritur kolegët tuaj, duhet ndryshuar ligji, që akademikët mos të dalin Emeritus 75 vjeç. Këtë po them unë.

Ndryshoni ligjin nr. 11, 19, 18,14, 15 dhe le të bëhet kryetar Akademie edhe një 76 vjeçar apo 77 vjeçar, por jeni në kundërshtim me atë që kanë bërë kolegët tuaj, sepse thoni që të rregullohet kjo. Le të rregullohet. Por nuk kemi propozim për ta rregulluar. Duhet një amendament tjetër. Duhet të hyjmë në një procedurë tjetër, sepse po u bë ajo, në nenin 4, që thotë se në asamble janë akademikët dhe akademikët e asociuar, duhet shtuar edhe akademikët emeritus. Pra, 30+10 nuk funksionon më. Do të funksionojë 30+10+20. Pra, do të kërkohen ndryshime të tjera. Unë jam dakord. Bëjeni këtë amendament. Shtyjeni pak këtë diskutim dhe shtoni edhe këto të tjerat. Unë

po ju them se ai ishte propozimi im. Mendojini të gjitha gjërat. Ka një ligj për shkencën. Bëni një ligj të ri. Pse jo. Unë këtë pyes. Çfarë është kjo urgjencë? Ju vetë sapo e thatë këtë gjë?

**Flutura Aça** - Faleminderit, zoti Fuga!

Fjalën e ka zoti Koçi dhe më pas zoti Metaj.

**Petro Koçi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Fuga, faleminderit që erdhët në këtë dëgjese në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik!

Edhe unë, ashtu si kolegu Nasufi, dua t'ju shpreh vlerësimin për energjinë dhe angazhimin që keni për çështje të ndryshme me interes publik, përfshirë edhe ato që lidhen me mënyrën si funksionon Akademia e Shkencave. Nëse përqendrohemi te kjo e fundit, zëri juaj, në fund të fundit, pavarësisht nëse një pjesë e botës akademike bie dakord apo jo, apo edhe ne të politikës, i shërben padyshim një rritjeje të nivelit të transparencës mbi këtë çështje.

E dyta, për sa i përket aspektit moral të projektligjit, unë jam nga të rrallët deputetë që në 21 prill të vitit 2008 kam votuar kundër ndryshimeve kushtetuese. Kur kam firmosur këtë projektligj, kam qenë po aq i qetë sa atëherë. Kjo do të thotë se ajo që kam propozuar për dy çështjet më themelore në projektligj, ashtu i mendoj dhe këmbëngul për to dhe prandaj firmosa që të kthehej në një projektligj dhe pastaj të niste procedura parlamentare.

Për sa u përket mandateve të kryetarit të Akademisë, unë nuk e kam ditur që ligji në fuqi garantonte dy mandate, por ato duhet të mos ishin të njëpasnjëshme. Kjo më është dukur një absurditet, pavarësisht emrit dhe faktit nëse kryetari aktual kandidon dhe mund të zgjidhet, pra, mund të përfitonte nga ndryshimi i ligjit.

Ligji ka efekte afatgjata.

E dyta, për sa i përket moshës së akademikëve dhe të drejtës së tyre për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, sërish mendoj që kufiri i moshës 75 vjeç është diskriminues për atë botë akademike, sepse, siç e kam thënë edhe në një tjetër komision, Akademia nuk është forum rinor, por është institucioni i mendjeve, të cilat, për shkak të angazhimit intelektual dhe përvojës, padyshim, detyrimisht mund ta interpretojnë maksimumin e vlerës së tyre, që nuk është për interesa personale, por për interesa duke filluar nga ato kombëtare dhe deri në interesa për grupe interesi apo institucione që mund të jenë për nga rëndësia kombëtare jo dhe aq të larta, por që gjithsesi, mbeten interesa publike. Prandaj, për atë çështje jam edhe sot shumë i qartë dhe me sa shikoj edhe ju e keni të njëjtin koncept, por gjykoni që në ligjin për shkencën ka një pengesë.

Ju thatë se jeni i vetëm. Kjo është e rëndësishme, siç është i rëndësishëm edhe fakti që sot ftesa që të vinin anëtarët e Akademisë në këtë dëgjese ka marrë dy përgjigje të ndryshme: ju me prezencë, kurse ata kanë sjellë një mendim me shkrim, ku shprehin mbështetjen për projektligjin.

I thashë këto duke u nisur nga fjala juaj, por edhe nga disa qëndrime publike, të cilat në dy raste kanë qenë edhe pak moralisht ngacmuese. Për shembull, unë jam një karakter politik që nuk kam nevojë të mbrohem as nga muret e Kuvendit dhe as ndonjë mur tjetër, por gjithsesi e kam marrë atë si një moment ndoshta me natyrë emocionale.

Së fundi, dua t'ju shpreh respektin, siç thatë ju, edhe për Fadilin edhe për shumë arsye të tjera!

Faleminderit!

**Flutura Aça** - Faleminderit, zoti Koçi!

Fjala për ju, zoti Fuga!

**Artan Fuga** – Faleminderit, zoti Koçi!

Pikërisht se janë arsyet e tjera mua më jep mbështetje për të kundërshtuar, duke ditur horizontet, por natyra ime është që unë ruhem pikërisht nga siguri jashtë logjike. Në jetën time, në momentin kur kam një siguri jashtë logjike, pra, përtej logjikës, filloj të jem i shqetësuar.

Unë ju falënderoj për vlerësimin, por siç i thashë edhe zotit Nasufi, zoti Koçi, ajo që unë prisja nga ju për një milion rrethana, sepse unë i di ato që treguat ju, edhe për Kushtetutën, është: Si është e mundur që unë lutem për t'i takuar dhe thënë dy fjalë, kurse dy zotërinjtë deputetë nuk vijnë të thonë hajde të pimë një kafe dhe thuaj çfarë ke për të thënë?

Vlerësimin unë do ta pranoja nëse do të kishte ndodhur kjo tjetra, por kjo nuk ka ndodhur, gjë që mua më bën të vendos barrierën dhe gardhin, zoti Koçi. Ju dhe zoti Beqiraj nuk keni vlerësim për mua (kjo është bindja ime, por mund të mos jetë e vërtetë, po jua them hapur dhe sinqerisht), se po të kishit, do të thoshit: “Artan, çfarë shqetësimi ke? Hajde ta bisedojmë. Nuk e keni atë vlerësim dhe nuk jua kërkoj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zotëri!

Unë nuk di të kem fyer personalitetin tuaj, di që kam shprehur gjëra pozitive, por nëse e kam shkelur, unë kërkoj falje. Por ta dini, edhe sot, edhe nesër, unë do të vazhdoj kritikën, të fortë, të ashpër, do të ngre të gjithë opinionin publik për mendimet e mia, pa u ndalur nga asnjë rrethanë apo vlerësim. Kjo është demokracia. Unë kështu e kuptoj.

Ju thoni se nuk e kam ditur për dy mandate. Zoti Koçi, juridikisht ju jeni i prezumuar se e dini. Kur thoni se nuk e dini, në planin juridik nuk ka asnjë vlerë. Më lejoni ta them këtë. Nuk mund të shfajësoheni tek ajo, por nuk ka pikën e rëndësisë.

Ju jeni gjithmonë në mbrojtje të atyre që drejtojnë akademinë. Është e drejta juaj, nuk e kam paragjykim. E shikoj hap pas hapi. Ju thoni është njësoj: ata e dhanë prezencën me anë të një letre, kurse ju erdhët këtu. Pra, vendosni shenjën e barazimit. Jo, zoti, Koçi, unë kam ardhur, po ju respektoj, po u përgjigjem pyetjeve tuaja me gjithë sinqeritetin tim, ndoshta edhe gabim, po ju jap argumente, kurse aty nuk ke asnjë argument, zoti Koçi. Ata janë burra më të mençur se unë, padyshim, por nuk kanë dhënë asnjë argument. Ju na barazoni duke thënë: ti ke ardhur këtu dhe ke 4 orë që punojmë bashkë, kurse ata shkruan një gjë. Nuk e beson njeri, zoti Koçi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ka dy alternativa thatë: ata e bënë kështu, ti e bërë kështu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk është zgjedhje, zoti Koçi. Nëse ju thoni këtë, ne nuk jemi dakord bashkë. Punë e madhe se nuk prish punë, por do të na gjykojë publiku.

Për mua ka një gjykatës dhe një pushtet mbi akademikët, mbi profesorët, mbi deputetët, që është publiku. Unë i drejtohem publikut, zoti Koçi. Nuk kam mënyrë tjetër unë. Nga viti 2008 deri në vitin 2019 me normat e demokracisë së shumicës mua më kanë thënë: “Ulu! - E the?- Po. - Pusho!”.

Derisa ka një pushtet më të madh, ka mure që shpërthejnë përpara opinionit publik.

Ju thoni se mosha 75 vjeç është diskriminuese nëse aty vendosen disa kufij. Jam dakord me ju. Zonja kryetare, nëse ne biem dakord këtu, edhe zoti Nasufi, edhe zoti Beqiraj, por edhe zoti Koçi se mosha 75 vjeç është ajo që pengon dhe duhet ndryshuar, ne paskemi rënë dakord. Kjo do të thotë se amendamenti duhet shtyrë, duhet parë i tërë ligji dhe nenet në mënyrë që të krijohet koherenca logjike. Ne jemi dakord. Kjo do të zbardhet.

Unë jam dakord me këtë, sepse këtë po them. Rregullojeni ligjin në atë mënyrë ose na caktoni një komisar të jashtëzakonshëm. Unë i pranoj të dyja. Ka gjendje të jashtëzakonshme në një institucion, që bëhet me anë të një vendimi politik nga Kryeministri, Kuvendi, nuk e di nga varet. Që 75 vjeçarët të diskriminohen, siç thotë zoti Koçi, dhe vetëm njëri prej tyre të mos diskriminohet, unë nuk e di nëse mundet dot që në opinionin publik ju këtu dhe unë bashkë me ju të mund ta mbrojmë këtë. Ne mund ta mbrojmë me forcën e votave, por ne shkelim Kushtetutën

dhe unë këtu nuk jam dakord me zotin Beqiraj kur thotë se çdo gjë është relative. Po, çdo gjë është relative, por ka disa gjëra që janë absolute, siç janë të drejtat e njeriut. Ato nuk ndryshojnë me kohën. Prandaj, jemi dakord.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Faleminderit!

**Flutura Açka** – Zoti Fuga, faleminderit!

Zoti Metaj, mund t'ju kërkoj leje që t'ia jap fjalën zonjës Nebiaj më parë? Ta shkartisim pak debatin me opozitën dhe pastaj e keni radhën ju.

Faleminderit!

**Oriela Nebiaj** – Faleminderit, zoti Metaj!

Profesor i nderuar, ndihem e lumtur që jam sot në këtë komision dhe po dëgjoj të gjitha argumentet tuaja, por sinqerisht ndihem e turpëruar për shkak se në këtë komision më duket sikur askush nuk po dëgjon atë që në vërtetë ju po e thoni dhe rithoni, që ky projektligj me këto ndryshime sjell disa kundërshtime strukturore, që duhen rishqyrtuar. Nuk e kuptoj pse këtu duhet të ketë një konflikt kur flasim, mbi të gjitha, për ndryshime që do të duhet të ishin në të mirë dhe në përmirësim zhvillimor të këtij projektligji, sidomos kur flasim për një institucion me emrat më të nderuar të shkencës, si Akademia e Shkencave.

Më duket një konflikt që tregon dhe flet shumë për të gjithë ne, për të thënë të drejtën. Ju falënderoj shumë që nuk keni pranuar vetëm që të firmosni diku, qoftë kundërshtimin, qoftë pranimin, por jeni sot këtu, duke bërë si gjithmonë atë që dini të bëni më mirë dhe të jeni, së pari, një qytetar i nderuar dhe më pas profesor i nderuar.

Unë i dëgjova të gjitha argumentet dhe patjetër që jam e paqartë. Si mund të bëhet një ndryshim në një ligj që ka kaluar 4 vjet më parë, për shkak se është bërë një gabim për mandatet e kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe sot ridiskutojmë ndryshime procedurale që, në fakt, në strukturë sjellin kundërshtinë brenda ligjit? Kjo është e padiskutueshme dhe e patolerueshme dhe s'kemi si ta diskutojmë, sepse ligji është një dhe i vetëm dhe nuk mund të ketë kundërshtime brenda vetes, sidomos kur propozohen ndryshime që duhet vetëm të përmirësojnë ose të sjellin një nivel zhvillimor për të gjithë grupin e interesit që prek ky ligj.

Si studentja juaj, së pari, dhe më pas si deputete e re dhe anëtare e këtij komisioni, jam e paqartë edhe për një pikë, duke qenë se dëgjova edhe nga zotërinjtë e nderuar, por edhe nga ju, të mbrohej argumenti i diskriminimit në moshë të anëtarëve. Pa diskutim, arsyetimi juaj apo edhe i



anëtarëve të nderuar të komisionit më vlen, por jam e paqartë vetëm në një pikë. Pse quhet barrierë që duhet hequr për Akademinë e Shkencave, anëtarin e Akademisë së Shkencave, për të drejtën për t'u zgjedhur dhe për të drejtën për t'u zgjedhur të këtyre anëtarëve, ndërkohë që ne kemi një ligj tjetër për profesorët dhe pedagogët që japin mësim, ku kufizohet mundësia për mësimdhënie sipas disa kriterëve që unë mendoj se duhet të jenë shqyrtuar kur është vendosur kështu? Domethënë, në analizë duhet të ketë një motor psikofizik që duhet të jetë shqyrtuar, por nuk e gjej veten të bëj një ekspertizë të tillë, por thjesht mund të ngre pikëpyetje, që përcakton se pedagogët lejohen deri në moshën 65 vjeç dhe kur je profesor i asociuar mund të lejohesh deri në 68 vjeç, pra, 1 vit më shumë nga mosha kur del në pension. Kjo ishte pyetja ime për ju dhe do të doja që unë dhe të gjithë ata që na ndjekin sot të marrim një përgjigje.

Faleminderit!

**Flutura Aça** - Faleminderit, zonja Nebijaj!

Urdhëroni!

**Artan Fuga** - Faleminderit, zonja Markiçi!

Sigurisht, ju nuk keni qenë asnjëherë studentja ime. Pra, nuk kemi asnjë konflikt interesi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më fal, zonja Nebijaj! Kërkoj ndjesë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk më dëgjuat, zoti Beqiraj!

Zonja Nebijaj tha: “Jam studentja juaj”. Unë dua të them për opinionin publik se nuk kemi marrëdhënie profesor-student, por marrëdhënie të njeriut qytetar që ka ardhur te deputetja. Kaq desha të them.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk jemi vetëm ne, zoti Beqiraj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë tregoj kujdes për opinionin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A është e drejta ime?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Faleminderit!

Vetëm një sekondë.

Pyetja që ju ngrini, zonja Nebijaj, është shumë e rëndësishme dhe kjo më jep mundësinë t'i rikthehem një çështjeje që më duket se e ngriti zoti Nasufi, i cili tha që dy mandate radhazi kanë edhe rektorët e universiteteve. Në qoftë se në ligjin "Për arsimin e lartë" rektorët e universiteteve kanë dy mandate unë heq kapelën, duartrokas, i bindem kësaj dhe vazhdoj punën. Është një kuadër tjetër juridik.

Si mund të arrijmë në arsyetime të tilla që të krahasojmë dy fakte juridike që u takojnë dy strukturave dhe dy platformave juridike të ndryshme? Të shpjegoj këtë unë tani? Unë nuk e di çfarë mund të bëj tjetër. Mund të rrimë me orë të tëra por nuk ka lidhje. Pra, unë nuk jam duke diskutuar nëse është mirë me dy mandate apo me një mandat. Nuk i hyj kësaj pune, sepse kjo është çështje votimi, kjo është e drejta juaj. Nuk ju bind unë juve as për njërin, as për tjetrën. Unë them se ndryshimi nga një gjendje në gjendjen tjetër është i pamundur të bëhet, sepse bie në kundërshtim, krijon atë kundërthënien, shkatërron Kushtetutën e të gjitha me radhë.

Pra, kur ju flisni për diskriminim unë ju jap plotësisht të drejtë që ju të kritikoni dhe të thoni pse thatë diskriminim, se po e thatë për këta, do ta thoni edhe për këta profesorët. Ju keni shumë të drejtë, por ky argument shkon ndaj të zotit Beqiraj dhe zotit Nasufi, sepse problemi është se në qoftë se është diskriminues për këta 75 vjeçar në Akademi, atëherë ta quajmë diskriminues edhe për profesorët, profesorët e asociuar e të tjerë që janë në universitete. Arsyetimi im është: Përderisa ligji thotë që në moshën 75 vjeç të reduktohen kompetencat, detyrimet, sepse për shkak të moshës konsiderohesh që nuk mund t'i ushtrosh ato, unë si qytetar mund të them që kjo nuk më pëlqen, por kur bëhet me ligj, atëherë them atë e di ligji. Argumenti im është që të gjithë 75 vjeçarët i privojmë dhe njërin prej tyre e lejojmë të vazhdojë. Kaq është. Më tutje le të diskutojmë sa të dëshironi ju, por kaq më mjafton mua për të thënë argumentin logjik që kjo nuk ecën.

Problemi është këtu. Unë po përpiqem të shtyj sa të jetë e mundur, edhe pse unë këtu nuk jam askush, në një kompromis. Përderisa zotërinjtë deputetë thonë që mosha 75 vjeç është diskriminuese, unë jam gati ta pranoj edhe atë. Unë nuk e kërkoj, por po e bëtë, unë nuk kam për të thënë që ndryshoi ligji që edhe 75 vjeçarët të mund të jenë anëtarë me të drejta të plota që të mund të zgjidhen. Unë nuk kam për ta hedhur kurrë gurin ndaj profesorëve të mi. Problemi është që nëse bëjmë këtë, kemi pranuar kjo nismë duhet të kthehet pas dhe në muajt shtator, tetor ose nëntor të rinisim nismën tjetër ligjore, e cila të diskutohet. Unë këtë po them dhe nga kjo pikëpamje unë nuk e kuptoj ku është kundërshtia.

Më falni, zonja Nebijaj! Ju kërkoj ndjesë!

**Flutura Aça** - Faleminderit, zoti Fuga!

Fjalën e ka zoti Metaj.

**Iir Metaj** - Në fakt, profesor, më duhet të them që unë e vlerësoj angazhimin tuaj qytetar mbi të gjitha në këtë aspekt, por patjetër edhe atë akademik dhe zërin tuaj kritik, sepse, pavarësisht nëse jam ose jo dakord me ato që thoni, për mendimin tim kritika është gjithmonë vlerë!

Edhe në rastin e sotëm unë mendoj ndryshe ose kundër nga ajo që ju mendoni. Sidoqoftë, ju falenderoj që erdhët, sepse të paktën mua më dhatë mundësinë të freskohem në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nga afër me tisin e një profesori filozof, akademik!

E lexova letrën tuaj. Pata dy reflektime të miat në formë dhe përmbajtje. Për të qenë i sinqertë, më duhet të them që ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Letrën publike.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** - Profesor, bëhet fjalë për letrën e parë që ju i keni drejtuar komisionit.

**Iir Metaj** - Ju mund të jeni profesor, por këtë e dini ju. Unë kam kryetare ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** - Ju lutem, profesor, depozitoheni në komision dhe do t'u shpërndahet kolegëve.

**Iir Metaj** - Ismet, të lutem, mos ta bëjmë kakofoni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pa problem. Unë e pranoj gjithmonë ndihmën, por jo kur nuk kam nevojë.

Unë kam një kryetare komisioni, që është zonja, e cila më ka dërguar një material. Unë në bazë të asaj letre po flas. Nuk e di çfarë ka profesori atje.

**Flutura Aça** – Profesor, nuk e kemi këtë material që keni referuar sot.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Fuga, deputeti i referohet letrës së parë. Besoj se e ka ndjekur edhe sot dëgjuesën tuaj. Kështu që, është i qartë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Metaj, duhet t'i referoheshit dëgjuesës së sotme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Iir Metaj** – Kryetare, ju lutem, a ka mundësi, sepse nuk ndërpreva asnjëri!? Kështu që, ju lutem, të mos ndërhyjë njeri kur unë flas!

Edhe nëse them ndonjë gënjeshtër, në fakt, nuk është gënjeshtër, sepse është letër reale. Çfarë rëndësie ka nëse është letra e parë, e dytë apo e tretë, nuk po diskutojmë hapat? Është një letër reale që më ka ardhur nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Sidoqoftë, profesor, nëse ju mendoni që është *nonsens*, më lini në kohën e *nonsens*-it tim. Më takon, për sa jam deputet.

Për sa i përket formës së asaj letre, në këndvështrimin tim ishte e tepërt ironia drejtuar deputetëve, sepse deputetët nuk e meritojnë atë lloj ironie në një letër publike, aq më tepër edhe në komunikim të drejtpërdrejtë. Ju e fillonit letrën me një ritëm shumë të lartë, me Euklidin, Pitagorën, Njutonin, pavarësisht se më pas kaloni te zërat e brendshëm apo të jashtëm që u flasin deputetëve, për ta mbyllur me fjalinë: “do marrim çiftin, të dalim për gjah”.

Megjithatë, ky është këndvështrimi dhe mendimi juaj filozofik i të drejtuarit të një ligjvënësi, qoftë edhe në publik. Më duhet të them, në fakt, që, në formë, siç e thashë, nisja juaj me ritëm aq të lartë, *heavy* dhe *high*, duke iu drejtuar ajkës së astronomisë, matematicinëve, fizikantëve apo filozofëve, edhe unë që jam një metalar profesionist, aq *heavy* dhe *high* që në fillim ishte pak e fortë.

Megjithatë, ma dha mundësinë për t’u ulur edhe më poshtë letrës dhe për të arritur deri te dy reflektime në përmbajtje. Sipas letrës, një nga vërejtjet tuaja ishte çështja e kufizimit apo jo të mandateve. Në fakt, ekzistojnë të dyja modelet, edhe modeli me mandat të kufizuar, madje edhe 1-vjeçar, por edhe me mandat të pakufizuar. Madje, ka edhe kryetar ë që janë në drejtim prej 15-20 vjetësh në vendet fqinje apo diku më larg. Do të thotë që ky nuk është një model që u shpik nga ne nga hiçi, por është një model ekzistues. Pastaj, është model që ka pikat e tij pozitive apo negative, kjo ngelet në këndvështrimin e secilit dhe është tjetër çështje.

Për të vazhduar më pas, ju thoni që votimi nuk është i lirë nga anëtarët e Akademisë, sepse ata janë nën hyqmin e kryetarit. Domethënë, ju vini në dyshim faktin nëse bëhet votimi i lirë apo jo në Akademi. Për mua, në fakt, kjo është shumë e rëndë, sepse ju, profesor, jeni duke ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Keni durim, profesor. Do keni kohë të përgjigjeni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju thatë që unë i mirëpres gjithmonë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po pra, por më lini të mbaroj. Dëgjojini dhe vërejtjet, sepse do të vij edhe te pyetjet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk kam nevojë për interpretim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mos më ndërpre më!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem shumë, a mund të pushosh?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ina, po të kërkosh opinionin tim se çfarë mendoj unë kur ti je duke folur, mund të dalësh edhe ti totalisht jashtë shinave. Kështu që, të lutem, më lejo të them atë që unë di. Unë nuk të ndërhyj, ndaj të lutem mos më ndërhy as ti.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po pra, respekto etikën. A të ndërhyj unë ndonjëherë kur flet?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Asnjëherë. Kështu që, të lutem shumë mos më ndërpre!

Ju, profesor, aluduat, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë në mënyrë të tërthortë, që në Akademinë e Shkencave ka trafikim votash. Nuk e di me shitje me akte financiare apo me trafik influencash, sidoqoftë ndryshon valuta, por tek e fundit është e njëjta gjë.

Ju jeni duke thënë që mendimi i ajkës dhe i shkencës në Shqipëri bën trafik votash, shet votën, sikurse një i pakënduar në një zonë të thellë. Kjo është shumë e rëndë. Të mendosh që Akademia ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E keni thënë, pra!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ja se po jua citoj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për mua apo për ju? E keni thënë, pra! Ja t'jua citoj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** - Zoti Fuga, lejojani të mbarojë fjalën.

**Ilir Metaj** - Jo, nuk kam pse e shtyp, se nuk kam mbaruar.

**Flutura Aça** – Jo, jo! Prit, zotëri!

**Ilir Metaj** - Një minutë sa të mbaroj!

Zonja kryetare, a mund ta respektoni fjalën time?

**Flutura Aça** – Po i thosha, zotit Fuga, që nuk regjistrohet nëse nuk e ka të hapur mikrofonin.

Ju lutem, duhet të prisni sa ta mbarojë fjalën deputeti dhe pastaj ta merrni ju fjalën, sepse nuk regjistrohet.

**Ilir Metaj** – Fatkeqësisht, ka në dorë të gjitha mekanizmat që të manipulojë vullnetin e votuesve atje në mënyrë artificiale që e bëjnë të përjetshëm....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, ekziston mundësia t’i manipulojë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po pra, ka, patjetër.

**Artan Fuga** – Edhe unë i kam të gjitha instrumentet që të shes prodhimin...

**Ilir Metaj** – Profesor, është shumë e rëndë ajo që thatë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mos më ndërprisni, profesor...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po e keni gabim, sepse i bie...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po më dëgjoni deri në fund dhe pastaj keni të drejtën e përgjigjes.

**Flutura Aça** – Zoti Fuga, kur të flisni, duhet të shtypni patjetër butonin se nuk regjistroheni.

**Ilir Metaj** – Dëgjojeni pyetjen e fundit dhe përgjigjuni, sepse unë nuk ju ndërpreva kur ju u përgjigjët.

**Flutura Aça** – Lëreni zotërinë ta mbarojë fjalën dhe pastaj merreni ju fjalën.

Zoti Metaj, ju lutem, konkludoni me pyetjet, ju lutem!

**Ilir Metaj** – Ju aluduat pikërisht që ajka e Akademisë së Shkencave dhe e mendimit shkencor dhe akademik shqiptar është në gjendje të tillë që mund t’i trafikojë votat.

**Artan Fuga** – Jo.

**Iir Metaj** – A ta lexoj edhe një herë?

**Artan Fuga** – E keni lexuar keq.

**Iir Metaj** – E kam lexuar keq, dakord.

A e shikoni ju këtë, sepse ju i referoheni pikërisht këtij risku, pra që mund të manipulohen votat. Ju jeni duke ngritur dyshimin që në Akademinë e Shkencave, ata që përfaqësojnë elitën e mendimit shkencor dhe filozofik shqiptar mund ta trafikojnë votën, sikurse...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pyetja që unë kam është: a keni ndonjë provë ose dijeni për shitje të tillë votash në Akademinë e Shkencave?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju po thoni që ky është rrezik. Ju e merrni këtë si fakt dhe si argument pse nuk duhet të ndodhë, ndërsa tani thoni që nuk ka ndodhur. Profesor, nuk ka pak shtatzënë, ose është, ose nuk është. Nëse ju aludoni për shitje votash në Akademinë e Shkencave, do të ishte mirë të tregoni faktin tuaj, nëse e dini ose në të kundërt mos ngrini një aludim të tillë mbi kolegët tuaj, sepse është një aludim shumë i rëndë.

**Flutura Aça** – Zoti Metaj, mbaruat apo keni akoma për të folur?

**Iir Metaj** – Kam ende për të folur.

Kisha edhe diçka tjetër.

**Flutura Aça** – Zoti Metaj, mund ta merrni prapë fjalën.

**Iir Metaj** – Jo, nuk kam mbaruar.

Kisha edhe një vërejtje sa i takon përmbajtjes, por për momentin po e lë.

**Flutura Aça** – Faleminderit, zoti Metaj!

**Iir Metaj** – Jo, nuk kam mbaruar akoma.

**Flutura Aça** – Mendova se mbaruat.

**Iir Metaj** – Meqë thatë faleminderit, po e lë me kaq, edhe pse nuk kisha mbaruar.

**Flutura Aça** – Unë falënderoj çdokënd, edhe ata që më shajnë unë prapë i falënderoj.

Ajo që dua t'ju them është se ishit pak i vrazhdë, por nuk kishit arsye të debatoni me kolegët këtu. Mbledhjen e drejtoj unë, kështu që e vendos unë se kush duhet të flasë ose jo.

Zoti Fuga, fjala për ju.

Zoti Metaj, dëgjojini përgjigjet e zotit Fuga.

**Artan Fuga** – Në filozofinë e historisë kjo quhet anakronizëm. Çfarë quhet anakronizëm? Ne jemi sot këtu, unë në respektin tuaj, tuajin personalisht, zoti deputet, por edhe të të gjithë deputetëve, nuk kam ardhur as me ndonjë letër me shënime, as në kulturën orale, por kam ardhur në respekt të asaj që ju më bëtë me një dokument të shkruar, aq sa di unë dhe do ta depozitoj. Ky quhet depozitim i dokumentit parashtresë përpara Komisionit, të nderuar, të Medias dhe Edukimit, në kundërshtim me amendamentet që janë paraqitur. Pse quhet anakronizëm? Nuk është fare pezhorative dhe nuk ka asnjë konotacion, sepse në vend që të diskutojmë këtë, po diskutojmë një letër të 3-4 muajve përpara, e cila ka një zhanër tjetër, ku unë nuk kam hedhur asnjë argument. Do të thoni ju, po unë nisur nga ajo letër po diskutoj. Pse kam ardhur unë sot me një dokument tjetër? Pse nuk e kam depozituar më parë? Sepse nuk kam asnjë detyrim, por nëse do ta kisha atë detyrim, do ta kisha depozituar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Deputeti ka të drejtë, zonja Açka, sepse, nëse unë do ta kisha detyrim, duhej ta kisha bërë, por nuk e kam.

**Flutura Açka** – Zoti Fuga, ju keni gati 2 orë këtu dhe deputet e kanë për detyrë dhe obligim të mbajnë shënime dhe të bëjnë pyetje në bazë të atyre që thoni ju, kështu që kjo është mëse normale.

**Artan Fuga** – Zoti deputet thotë se unë kam bërë aludime në letër sikur trafikohen votat në Akademinë e Shkencave. Zoti deputet, siç jua thashë edhe më parë, edhe unë mund të bëj gabime, por unë jam njeri i komunikimit, kështu që atë gabim nuk e bëj aq kollaj. Më duhet t'ju them se unë e di çfarë është neni, çfarë është neni i fyerjes, neni i shpifjes, neni i akuzës, kjo edhe ajo, por nëse ju keni argumente për të më hedhur në gjyq për këtë, më hidhni, por edhe si i burgosur unë kam të drejtë të dërgoj një paraqitje në komision dhe t'ju them: ore unë i burgosur jam për fyerje dhe akuza, por për komisionin kam këtë parashtresë për amendamentet. Pra, të mos i ngatërrojmë këto gjëra, aq më shumë që citoni në një mënyrë, gjë, e cila nuk ka fare lidhje me akuzën që më bëjnë, se unë kam thënë "hyqmin". Në radhë të parë unë këto turqizmat nuk i përdor kurrë, por kam thënë, rrezikon.

Ju, zotit deputet, duhet ta dini që ligji bëhet, sepse njeriu merret në parim si i keq dhe jo ky apo ai. Mua më duket sikur ne nuk po e kuptojmë thelbin e ligjit dhe në këtë mënyrë disa shprehje merren si fyerje. Hajde ta supozojmë se ju fyeva, por përsëri i kemi ato moskuptimet, unë po habitem me faktin se në çfarë situatë jam vënë sot, sepse vërtet edhe për mua është një mësim i



madh. Ndërkohë, është edhe fakti që tha zonja Zhupa pak më parë, sepse unë nuk po diskutoj a është model i mirë apo i keq, a është model i mirë me 2, 3 apo 5 mandate, por po e përsëris pa fund faktin hajdeni ta bëjmë me 2, 3, 4, 5 apo sa të doni, por problemi është që duhet ta bëjmë mbi bazën e një ligji dhe të një procedure dhe nuk është vetëm puna e mandatit, që kjo duhet bërë shpejt, pra para tetorit, duhet bërë me 2 mandate radhazi, duhet shtuar edhe mosha 75 vjeç dhe si t'i fusim ne të gjitha këto.

Bëjeni me 2 mandate dhe lëreni 75-vjeçarin pa e bërë, ndërkohë unë po e pranoj, sepse nuk ka një kundërthënie brenda ligjit, por problemi qëndron se nuk është vetëm kjo. Më falni për ndërhyrjen, por unë nuk mund të pranoj që të interpretohem në atë mënyrë, gjë, e cila përmban një akuzë, ndoshta pa dashje, sikur unë kam fyer deputetë, këtë apo atë. Jo, diçka të tillë nuk mund ta pranoj.

**Flutura Açka** – Zoti Fuga, faleminderit!

A e dëshiron ndonjë tjetër fjalën për të bërë pyetje?

Ju lutem, mos bëni debate me zotin Fuga, debatin do ta bëjmë ndërmjet nesh.

**Ilir Metaj** – Jo, nuk dua të bëj debat, por dua t'i them profesorit, siç edhe ju e patë, që unë nuk ju ndërpreva, por ju dëgjova deri në fund.

**Artan Fuga** – Edhe unë nuk ju akuzova për atë gjë.

**Flutura Açka** – Faleminderit, zoti Metaj!

Kam diçka të fundit për t'ju thënë, zoti Fuga.

Ju falënderoj shumë për prezencën!

T'ju them të drejtën, duke ju dëgjuar ju këtu, them: o Zot shyqyr që ka ca si ju këtu, në këtë det të kripur ku notojmë, ka disa pika të pastra uji.

Ju falënderoj shumë në emër të komisionit, por edhe në emër të mazhorancës, jam e bindur për këtë gjë, sepse rrallë kemi fatin të dëgjojmë njerëz shumë të mençur, pa asnjë lloj konflikti, këtë e them hapur, duke lexuar veprën tuaj dhe duke ju ndjekur edhe publikisht.

Këtu u fol sikur mbledhja u zgjat shumë, në fakt, mbledhja nuk ka zgjatur shumë, sepse ne kemi ndenjur këtu edhe për 70 mijë lekë të reja për Akademinë, madje i kemi dhënë Akademisë edhe 3 projekte të mëdha, madje i kemi votuar këtu bashkë, të cilat përbëjnë miliona euro të taksave të shqiptarëve, gjë, e cila do të thotë që ne me Akademinë jemi treguar *fair*, pra jemi treguar shumë të mirë me ta, por anëtarët e saj nuk kanë begenisur të raportojnë qoftë edhe një herë të vetme, të paktën për aq kohë sa unë jam në krye të këtij komisioni, megjithatë kjo është çështje e tyre.

Sa i takon votimit në parim, unë e para do të votoja, nëse kjo parimisht është e saktë, por me një kusht, që ta votojmë më 1 dhjetor, sepse do të isha e bindur që këtu luhet për parimet, në këtu jemi për parimet dhe jo për emra dhe për ligje nominative. Megjithatë, unë nuk kam arsye pse ta vë në diskutim këtë gjë, atë e dinë kolegët.

Duke u nisur nga ato që ju thatë, një qasje shumë e imtë dhe shumë e nevojshme për këtë komision, por edhe për publikun e gjerë, pra duke ju dëgjuar ju, profesor Fuga, edhe atë empati të vogël që kisha në lidhje me projektligjin që kanë sjellë dy kolegët e mi, pra kisha një farë empatie për ta në sensin se e kanë nisur ashtu siç e kanë menduar dhe asaj që kanë besuar dhe besojnë, kanë të drejtën e tyre ta besojnë, atë empati nuk e kam më tani që ju dëgjova ju dhe argumentet tuaja.

Kam vetëm një këshillë personale për ju, mund ta merrni edhe në mënyrë sarkastike, mos guxoni të kandidoni për kreun e Akademisë, sepse ky komision do t'jua presë krahët me gërshërë rrushi.

Ju falënderoj për gjithçka!

**Artan Fuga** – Falënderoj të gjitha zonjat dhe zotërinjtë deputetë!

Ju falënderoj ju personalisht për mundësinë që më dhatë!

Dua t'ju them se unë e dalloj debatin e ideve, kundërshtimin për këtë nismë, të cilën unë e konsideroj joligjore dhe që bie në kundërshtim me të gjitha aspektet kushtetuese, duke krijuar një ligj kundërthënës në Akademi, por kjo nuk ka të bëjë fare me respektin ndaj deputetit dhe ndaj njeriut. E gjithë dëshira ime është që ne të kemi në akademi shkencash, një kërkim dhe një botë shkencore që të jetë e bazuar në një ligji që u jep mundësi zhvillimeve.

Duke ju falënderuar përsëri, dua t'ju them se për mua duhet rishikuar, nëse gjendet e arsyeshme, i tërë ligji për Akademinë e Shkencave brenda kuadrit të përgjithshëm të projektit dhe të draftit të ligjit për shkencën, sepse vetëm në atë mënyrë mund të vijmë te kuptimi i neneve.

Me keqardhje mund t'ju them se unë po largohem, atë që kisha për t'ju thënë, jua thashë, i harxhova të gjitha argumentet e mia të sinqerta për t'ju thënë që kjo nismë të mos vazhdojë më tutje. Më pas çdo gjë varet nga vullneti juaj.

**Flutura Aça** – Faleminderit, zoti Fuga!

Mbledhja mbyllet këtu.

Do të vazhdojmë më pas me mbledhjen tjetër.

Faleminderit!

*Mbyllet pika e parë e rendit të ditës*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 10.7.2023, ora 13:30

**Drejton mbledhjen:**

**Flutura Aça – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

2. Diskutimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 53/2019, datë 18.7.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë””.

**Marrin pjesë:**

Flutura Aça, Petro Koçi, Lindita Buxheli, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Ilir Topi, Ilir Metaj, Ina Zhupa, Andia Ulliri, Merita Bakiu, Eralda Bano, Kastriot Piroli, Oriola Nebijaj, Ismeti Beqiraj(zëvendësues) dhe Fadil Nasufi (zëvendësues).

**Mungojnë:**

Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi dhe Agron Gjekmarkaj.

### *Vijon pika e dytë e rendit të ditës*

**Flutura Aça** – Të nderuar kolegë, vazhdojmë me mbledhjen e radhës së Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit. Siç edhe ju jeni në dijeni, sipas rendit të ditës, kemi diskutimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 53/2019, datë 18.7.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë””, propozim i një grupi deputetësh, datë 9.1.2023. Ne jemi komision përgjegjës, ndërsa komision për dhënie mendimi ka qenë Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, i cili e ka miratuar.

Para se të fillojmë me projektligjin, unë kam një shqetësim që dua ta diskutoj me kolegët, para se t’jua jap fjalën propozuesve, pasi këto janë gjëra që duhen sqaruar që në fillim. Komisioni i Ligjeve dhe Shërbimi Juridik kanë ngritur një shqetësim, i cili ka lidhje me një kërkesë që i bëhet komisionit tonë para se ta shqyrtojë projektligjin, që duhet t’i drejtohet për mendim Këshillit të Ministrave, lidhur me efektet financiare eventuale që mund të sjellë miratimi i projektligjit. Kërkesa është bërë edhe nga Shërbimi Juridik, por edhe nga Komisioni i Ligjeve.

Ne duhet ta vendosim bashkë, nëse duhet të jenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave për ta mbrojtur këtë gjë, pra nëse duhet ta shqyrtojmë sot apo duhet të presim të vijnë edhe ata dhe ta kalojmë në votim ose ta shtyjmë për nesër apo pak më vonë, por ne nuk mund ta kalojmë ligjin pa qenë kjo gjë e saktë, kjo gjë nga Ministria e Financave, pasi është një përgjegjësi ligjore, të cilën, unë personalisht nuk e kapërdij dot.

Po, zonja Zhupa.

**Ina Zhupa** – Faleminderit, kryetare!

Kam të njëjtin shqetësim, por dua t’ju sqaroj dy momente të gjithë anëtarëve të komisionit në lidhje me procedurën. Si relatores ligjin e kam lexuar me kujdes dhe në nenin 6 të ligjit, pra të ndryshimeve ligjore që ju keni sjellë, thuhet, e cila lidhet me pagat...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk kam filluar me projektligjin.

**Flutura Aça** – Zoti Beqiraj, është për procedurë.

Siç jua thashë edhe më parë nuk kemi filluar ende me shqyrtimin e projektligjit.

**Ina Zhupa** – Në projekt në nenin 6 thuhet: “Pagat e anëtarëve të kryesisë janë sipas tabelës bashkëngjitur këtij projektligji”, ndërsa “për punonjësit dhe drejtuesit shkencorë joadministrativë, si dhe atyre të njësive të kërkimit dhe studimit, përcaktohen sipas nenit 19, pikat 3 dhe 4 të këtij ligji”. Pra, është e qartë, siç e thotë edhe Komisioni i Ligjeve, por edhe memoja e Shërbimit Juridik të Kuvendit, ky projektligj është një propozim i ardhur nga një grup deputetësh dhe ka efekte financiare. Për këtë ne jemi të detyruar, sipas nenit 82 të Kushtetutës, zoti Beqiraj, i cili parashikon se propozimi i ligjeve kur është rasti, duhet të shoqërohet kurdoherë me raport që për ligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij. Asnjë, e nënvizoj, projektligj joqeveritar që bën të nevojshëm rritjen e shpenzimeve ose i pakëson shpenzimet, nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së projektligjit. Në qoftë se Këshilli i Ministrave nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, atëherë projektligji kalon për shqyrtim sipas procedurës së zakonshme.

Ajo që ne kemi për detyrë, sipas Rregullores së Kuvendit, neni 68 i Rregullores, si komisioni përgjegjës është që t’ia përcjellim menjëherë Këshillit të Ministrave. Po ju lexoj edhe detyrimin e Rregullores, pra nuk ka nevojë për votim për këtë çështje, sepse Rregullorja nuk votohet, por zbatohet, neni 68, pika 3/1: “Komisioni përgjegjës kur konstaton se projektligji joqeveritar, në këtë rast nismë e deputetëve, ka faturë financiare, pasi e përfshin atë në kalendarin e punimeve të komisionit, siç e kemi bërë ne, ia përcjell menjëherë Këshillit të Ministrave”. Në këtë aspekt ne nuk kemi asnjë mundësi që të vendosim ta votojmë, ta përcjellim apo jo, sepse Kushtetuta dhe Rregullorja e kanë të vendosur që ne kemi detyrimin ta përcjellim.

Po ju sjell një rast analog. Në projektligjin tim për ndryshimet në ligjin e trashëgimisë kulturore unë nuk kam as kosto financiare, sepse them që të mos jepen me koncesion, por prapë nisma e deputetit gjithmonë i dërgohet Këshillit të Ministrave, duke qenë se është detyrim i Kushtetutës dhe i Rregullores dhe mund të sjellë jo vetëm ndryshime financiare, por për të dhënë edhe këndvështrimin e vet si organi më i lartë i qeverisës i vendit. Në këtë rast fatura financiare është edhe më e evidente, sepse e thotë vetë neni 6. Të njëjtin rekomandim e kemi edhe nga Komisioni i Ligjeve, i cili ia ka dhënë si detyrim komisionit përgjegjës, por kemi edhe Rregulloren dhe Kushtetutën që na detyrojnë t’i dërgojmë një letër dhe t’ia përcjellim projektligjin e zotit Beqiraj, Këshillit të Ministrave dhe të presim 30 ditë për përgjigjen. Të jeni të qetë, sepse nëse për 30 ditë nuk sjellin përgjigje, atëherë ne mund ta fusim në shqyrtim. Unë jam e bindur që për 30

ditë ata do të sjellin përgjigje dhe ne do të mund të diskutojmë edhe në bazë të mendimit të Këshillit të Ministrave.

Sugjerimi im është që ne të zbatojmë Rregulloren dhe Kushtetutën, si dhe detyrimet që rrjedhin edhe nga raporti i Komisionit të Ligjeve dhe memoja e Shërbimit Juridik të Kuvendit, të pavarur dhe të paanshëm në lidhje me qasjen legjislative, ne ta shtyjmë pasi të na vijë edhe mendimi i Këshillit të Ministrave për të bërë një diskutim sa më efektiv të projektligjit, për t'u drejtuar edhe pyetjet e duhura propozuesve dhe për të marrë për bazë edhe çështjet tona të diskutimit, më pas edhe të votimit, por edhe aspektet financiare. Kjo nuk na ndaloi ne të bënim një seancë dëgjimore, absolutisht, sepse nuk lidhet me këtë gjë, nuk kishim as ndonjë ndalesë rregulloreje për prezantimin e zoti Beqiraj, por unë mendoj se është më efektive kur bëhet prezantimi dhe diskutimi, më pas edhe votimi, në të njëjtën ditë, dhe të mos e bënim me seanca të ndara, në kuptimin që zoti Beqiraj thjesht prezanton dhe më pas diskutimi dhe votimi të bëhej në një seancë tjetër.

Megjithatë, kjo e dyta mund të jetë çështje votimi, por është e ndaluar nga Rregullorja dhe nga Kushtetuta që ne sot të diskutojmë dhe të votojmë një projektligj që nuk i ka kaluar më parë për mendim Këshillit të Ministrave.

Këto i thashë në cilësinë e relatores dhe i kisha përfshirë edhe në relatimin tim. Pra, është e pamundur që të vazhdojmë në shkelje të Rregullores, sepse u bëjmë dëm edhe vetë propozuesve, pasi bëhet një ligj i atakueshëm dhe i pazbatueshëm.

Faleminderit!

**Flutura Açka** – Zonja Zhupa, faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, vetëm një sekondë, sepse kam një ndërhyrje të vogël.

Përveç kësaj, Akademia e Shkencave ka marrë ftesë, sepse ajo është gjithmonë e pranishme kur ne flasim dhe diskutojmë projektligje, që kanë lidhje me punën e saj. Kështu që unë nuk e kuptoj pse ata nuk janë këtu të pranishëm, sepse duhet të ishin këtu apo jo, zoti Beqiraj?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju nuk jeni përfaqësuesi i tyre, ju jeni deputet i parlamentit dhe ata duhet të ishin këtu dhe të diskutonin bashkë me ne këtë projektligj dhe t'u përgjigjeshin pyetjeve, që mund të kishin deputetët në raport me ta. Megjithatë, ky është problemi i tyre, por nuk është normale në procedurat e këtij komisioni që pala, në këtë rast Akademia e Shkencave, të mos begenisë të vijë. Më falni që

po e përdor fjalën “begenis”, por duhet të ishte këtu dhe të na respektonte, të paktën aq sa kemi pasur ne respekt për Akademinë kur kemi kaluar ligje, me votim të plotë, edhe majtas, edhe djathtas, për të bërë një mbarëvajtje të punëve të Akademisë së Shkencave.

Fjala për ju zoti Beqiraj dhe, më pas, zoti Koçi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ismet Beqiraj** – E kam për procedurë.

Në radhë të parë dua ta filloj diskutimin me këtë të fundit, pasi është në interesin e këtij komisioni dhe tonin, si nismëtarë, por edhe të relatorëve dhe do të na vlente, pavarësisht se mendimi i Asamblesë së Akademisë së Shkencave është dhënë edhe në letër, edhe prezenca e tyre për debat, pasi, sigurisht, që do të ketë pyetje. Unë besoj se arsyeja e mosardhjes së tyre duhet të jetë për shkak të orarit të zgjatur në dëgjuesën e parë dhe njoftimi për ta duhej të ishte rifreskuar.

Megjithatë, do të flas për procedurë...

**Flutura Açka** – Zoti Beqiraj, ju nuk jeni këtu për të justifikuar Akademinë e Shkencave. Ju lutem, qëndroni te përgjegjësia juaj.

**Ismet Beqiraj** – Aspak, sepse edhe mua më intereson që ata të ishin këtu sot dhe kjo është logjika.

Realisht unë kam ardhur me një draft të formatit tabelor, ku ligji është në kolonën e parë bazë, pra propozimi që kemi bërë ne, dhe në kolonën e tretë janë reflektuar të gjitha sugjerimet dhe diskutimet gjatë prezantimit të Komisioni i Ligjeve, si dhe gjatë konsultimeve të tjera...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, Ina!

**Ina Zhupa** – Ju e morët fjalën për procedurë...

**Ismet Beqiraj** – Po, për procedurë e kam.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po hiqeni këtë zakon, ju lutem, kini respekt!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk të shtohet audienca medietike kur bën...

**Flutura Açka** – Zoti Beqiraj, unë vetëm dua t’ju pyes: a na e keni dorëzuar ju këtë material? Është mirë që ta kemi edhe ne këtë material dhe nuk kemi pse të zgjatemi në debate, kur është e saktë ajo që ju thoni. Pra, a e keni dorëzuar ju këtë material?



**Ismet Beqiraj** – Unë dhe zoti Petro, si nismëtarë, jemi në dijëni të kësaj pune dhe duke marrë në konsideratë këtë ngërç dhe këtë problem, që ka të bëjë me pagat e anëtarëve të kryesisë e të tjera, e kemi riformatuar projektligjin, gjithashtu edhe sipas këshillimit të kolegëve të pozitës dhe opozitës në diskutimet që bëmë te Komisioni i Ligjeve, por edhe sugjerimet që kemi bërë në të dy si nismëtarë, me kërkesën tonë te kryesia e Akademisë së Shkencave. Në shkresën zyrtare anëtarët e kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe anëtarët e asamblesë bëjnë me dije se janë dakord me variantin tonë final, pas reflektimit që ne kemi bërë.

**Flutura Aça** – Zoti Beqiraj, ju thatë për procedurë.

**Ismet Beqiraj** – Unë si nismëtar, bashkë me kolegun Koçi, kam të drejtë të reflektoj, sigurisht, siç reflektohen të gjitha ligjet, nenet...

**Ina Zhupa** – Duhet ta kishte edhe opozita këtë material.

**Ismet Beqiraj** – Patjetër, duhej ta kishte.

**Flutura Aça** – A përfunduat, zoti Beqiraj?

**Ismet Beqiraj** – Ndaj, unë them se duhet të vazhdojë procedura normale.

**Flutura Aça** – Zoti Beqiraj, ju keni ardhur me një draft, pra i keni sjellë këtij komisioni një draft dhe ky komision është përgatitur për atë draft që ju keni sjellë. Ky draft ka qenë edhe në Komisionin e Ligjeve dhe Komisioni i Ligjeve është shprehur me një relacion mbi një draft të caktuar dhe vjen me një sugjerim për komisionin përgjegjës, që duhet ta ketë parasysh atë relacion që kanë dërguar ata. Tani, ju po më thoni se e keni përmbysur të gjithë procedurën. Ne nuk jemi këtu shtu ujë, shtu miell, zoti Beqiraj.

Ne jemi deputetë të parlamentit dhe flasim me letra. Mua më ka ardhur një shkresë me firmën tuaj, zotëri, dhe mbaj përgjegjësi për atë shkresë dhe kjo shkresë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më lini të mbaroj, ju lutem!

**Ismet Beqiraj** – Çështja është edhe lidhur me atë shqetësim, që ngriti zonja Ina Zhupa.

**Flutura Aça** – A mund të mbaroj argumentin tim, ju lutem?

Zoti Beqiraj, nuk regjistroheni pa jua hapur unë mikrofonin.

**Ismet Beqiraj** – Nuk ka problem, le të mos regjistrohem.

**Flutura Aça** – Ka shumë problem, se duhet të regjistroheni.

**Ismet Beqiraj** – Unë po flas për procedurë.

**Flutura Aça** – Zoti Beqiraj, a mund ta përfundoj unë argumentin?

**Ismet Beqiraj** – Kjo nuk e pengon këtë gjë dhe nuk kërkon mendim.

**Flutura Aça** – Zoti Beqiraj, a mund ta përfundoj unë argumentin?

Me këtë shkresë ka punuar Komisioni i Ligjeve dhe ka dalë me një relacion, që është një gjë e protokolluar dhe nuk mund të bëjmë shaka të kësaj natyre. Mos më shtyni mua të merrem me të tilla gjëra, që nuk janë për fajin tim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, unë kam ardhur me shumë seriozitet dhe kam shkruar 10 faqe për t'ju bërë pyetje...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zotëri, kam disa ditë që punoj, në mënyrë që të bashkëpunoj me ju dhe të bëjmë një ligj të mirë. Ja ku i kam këtu letrat, kam dëshminë që kam punuar me shumë seriozitet dhe sot vij dhe gjej në relacion që nuk mund ta kaloj dot ligjin dhe nuk punoj dot me ligjin, megjithëse këta kolegë kanë ardhur nga rrethet, sepse ju keni bërë një gabim në ligj. Kjo është çështja juaj, por unë sot...

**Ismet Beqiraj** – Çfarë gabimi kam bërë në ligj?!

**Flutura Aça** – Unë jam e detyruar të shkoj dhe t'i kërkoj qeverisë shqiptare, Ministrisë së Financave, një relacion nëse ky projektligj do të ketë pasoja apo jo në buxhetin e shtetit. Komisioni i Ligjeve dhe Shërbimi Juridik më thotë: “Zonjë e nderuar, para se të kalosh në diskutimin e këtij projektligji, pyet njëherë qeverinë nëse ka apo jo probleme. Nëse nuk ka, shumë mirë, mbajeni letrën, merreni këtë shkresë të Ministrisë së Financave dhe futeni në dosjen tuaj, zonjë, kur ta diskutoni ligjin dhe thërrisni këtu në komision përfaqësuesin e ministrisë...”

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, të mbaroj, zoti Beqiraj!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Beqiraj, mos m'u mbivendosni kur flas, se unë nuk ju mbivendosem kurrë!

Rregullorja më thotë: kërkonte që të vijë këtu përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe ta thotë botërisht para komisionit që ky ligj nuk ka asnjë efekt financiar sot dhe nuk do të ketë edhe nesër. Kështu është Rregullorja dhe unë jam e detyruar të zbatoj Rregulloren, nuk marr përsipër të marr gjëra që nuk më takojnë mua, se janë shumë të mëdha për shpatullat e mia.

Unë kam një Rregullore...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë, le ta vendosim, ta thërrasim bashkë dhe nuk kam asnjë kundërshtim. A doni ta thërrasim që nesër? Sepse që nesër e thërrasim. Unë jam përgatitur, zoti Beqiraj, me të gjithë seriozitetin tim, të paktën siç e njoh unë veten, për t'ju bërë pyetje që të përmirësojmë ligjin. Kështu që nuk është faji im dhe mos më kërkoni gjëra që nuk janë në kompetencën time. Unë kam dy relacione dhe jam e detyruar që të respektoj ato që më sugjerojnë kolegët e mi. Janë njerëz juristë, nuk janë si puna ime, shkrimtarë, që mund të rrëmben nga emocioni dhe them që kam shok zotin Beqiraj dhe hajde ta kalojmë këtë punë kështu, se unë nuk e kaloj dot këtë punë kështu.

Kjo është ajo që unë konkludoj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, e vendosim bashkë, nuk kam asgjë kundër ndaj asnjërit, por Rregullorja është Rregullore.

**Ismet Beqiraj** – Ju lutem, a të them edhe diçka tjetër?

**Flutura Aça** – Ju nuk mund të vini sot me idenë se kështu e keni menduar që ta rregulloni këtë punë, ndërkohë që komisionet e tjera...

**Ismet Beqiraj** – Jo, unë nuk e kam menduar këtë, por korrigjime edhe ne bëjmë, se ndaj kalon te Komisioni i Ligjeve.

**Flutura Aça** – Ju do ta kaloni te Komisioni i Ligjeve dhe pastaj...

**Ismet Beqiraj** – Ne, si nismëtarë, kemi tagrin që të propozojmë, si çdo deputet tjetër, dhe ju ose e lini, ose e hiqni. Kjo është një praktikë normale në veprimtarinë e komisioneve dhe nuk bëhet për herë të parë.

**Flutura Aça** – Zoti Beqiraj, mos u mbivendosni te fjala ime!

Komisioni i Ligjeve ka punuar mbi një draft që keni depozituar në Kuvend dhe pas këtij drafti ka ardhur këtu me një relacion dhe unë jam e detyruar që ta respektoj atë.

Tani, meqenëse ju keni bërë ndryshime dhe ia propozoni vetëm këtij komisioni dhe jo Komisionit të Ligjeve, i cili tashmë e ka bërë detyrën e tij, atëherë unë nuk mund të vazhdoj dot, pa kaluar këto ndryshime te Komisioni i Ligjeve.

**Ismet Beqiraj** – Unë do të propozoj gjatë diskutimit, nuk do të propozoj tani.

Pra, kur të diskutohet neni...

**Flutura Aça** – Po çfarë të bëj unë me relacionin e Komisionit të Ligjeve?

**Ismet Beqiraj** – Kjo është procedura, që kur shqyrtohet një nen unë, si propozues, kam të drejtë të them se këtë gjë do ta ndryshojmë, sepse kam marrë në konsideratë edhe reflektimet e Komisionit të Ligjeve, si dhe sugjerimet e Akademisë së Shkencave, që është palë e interesuar.

**Flutura Açka** – Zoti Beqiraj, unë nuk marr përsipër t'ju bind ju, se nuk është kjo detyra ime.

**Ismet Beqiraj** – Po kështu është Rregullorja...

**Flutura Açka** – Rregullorja është këtu. Çfarë do të bëni me këtë relacion? Më ktheni këtë relacion, çojani Komisionit të Ligjeve draftin...

**Ismet Beqiraj** – Ju lutem...

**Flutura Açka** – Nuk ka diskutime për këtë gjë.

**Ismet Beqiraj** – Në qoftë se ju do të ngrini artifica për të mos e zhvilluar këtë mbledhje, jam dakord, por nuk është përgjegjësia ime se ju nuk keni njoftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

**Flutura Açka** – Jo, nuk ngre fare artifica unë, madje nëse doni ta dini të vërtetën, për fat, unë e kam lexuar në fund fare relacionin e Komisionit të Ligjeve. Pra, pas 10 shkresave, kur kam bërë analizën, e kam lexuar në fund relacionin.

**Ismet Beqiraj** – Pas kësaj është edhe një akt normativ, por e ka miratuar Kuvendi dhe nuk zhbëhet ky akt normativ. Ky akt nuk është për ta miratuar ne, se ne nuk miratojmë këtë akt normativ që ka kaluar në Kuvend, por është për të bërë me dije.

**Flutura Açka** – Zoti Beqiraj, më lini të mbaroj...

**Ismet Beqiraj** – Qoftë niveli i pagave, kategoritë e të tjera janë këtu dhe nuk e luan topi këtë gjë.

**Flutura Açka** – Zoti Beqiraj, atë draft ia keni dorëzuar Komisionit të Ligjeve dhe Komisioni i Ligjeve ka punuar mbi atë draft.

**Ismet Beqiraj** – Po, por e keni edhe ju këtu, se është dokument kuvendor ky.

**Flutura Açka** – Duhet të filloni nga Komisioni i Ligjeve, zotëri, dhe mos më fajësoni për një gjë që nuk e kam unë fajin.

**Ismet Beqiraj** – Ju lutem, se nuk ka nevojë për tabela, siç e thashë, se e keni vendimin, aktin normativ të Kuvendit.

**Flutura Açka** – Zoti Beqiraj, është faji i moskoherencës suaj dhe moskonsultimit me juristë.

**Ismet Beqiraj** – Jo, nuk është fare faji im.

**Flutura Açka** – Zoti Koçi, fjala për ju.

**Ismet Beqiraj** – Ti nuk e ke filluar diskutimin.

**Flutura Açka** – Po nuk e filloj diskutimin, se ju nuk po më lejoni.

**Ismet Beqiraj** – Ju keni marrë një indicie, që deputetja do që të shtyjë patjetër këtë seancë dhe do ta çojë me ndërhyrje politike, me oreks politik.

**Flutura Açka** – Jo, mos më akuzoni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Zhupa, ju lutem!

**Ismet Beqiraj** – Filloni me procedurat, zonjë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kur të shkojmë te neni përkatës që do të diskutojmë, atëherë do të flas që ky nen kërkon edhe mendimin e kësaj.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Zoti Beqiraj, mos flisni, se nuk po regjistroni!

A mund të më dëgjoni, se e kam unë fjalën tani?!

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ju po më fyesi shumë rëndë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Para se të fliste zonja Zhupa, unë nuk e di fare se çfarë ka pasur në mendje, zonja Zhupa.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Nuk jua kam dhënë fjalën, zotëri, por, ju lutem, ta mbaroj unë argumentin!

Zoti Beqiraj, ju më fyesi rëndë, kur më thoni se kam marrë indicie nga zonja Zhupa për të bërë këtë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Është shumë fyese, ndaj, ju lutem, tërhiqeni mbrapsht këtë gjë. Nuk më drejton dot këtu as zonja Zhupa dhe as Zoti në këtë komision, ju lutem shumë!

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ju duhet ta zbatoni procedurën, duhet të shkoni te Komisioni i Ligjeve në bazë të Rregullores së këtij Kuvendi. Nëse ju keni bërë gabimet tuaj rrugës, është problemi juaj dhe jo imi. Mos më fajësoni dhe mos më ngarkoni me faje që as nuk kam pasur ndër mend t'i bëj dhe as nuk

kam ndër mend t'i bëj, zotëri! Nëse e keni bërë gabimin, shkoni dhe ndreqeni gabimin te burimi, jo me mua.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Zonja Zhupa, po flas unë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Pushoni, ju lutem, se po flas unë!

Zoti Beqiraj, ju keni bërë një gabim rrugës dhe kjo është çështja juaj, ndaj unë nuk merrem me këtë çështje. Kur ju më thoni se më drejton zonja Zhupa, aq më tepër zonja Zhupa, me të cilën kam pasur debate publike, të më drejtojë mua, kjo është fyese. Pra, nëse ka ndonjë koleg këtu që unë e dëgjoj të fundit, është zonja Zhupa dhe nuk e them për ta fyer, por e them për shkak të konfliktit, se unë nuk kam pasur asnjëherë konflikt me zonjën Zhupa.

Unë, zotëri, lexoj shkresa dhe eci me shkresa dhe Rregullore. Rregulloni shkresën, zotëri, para se të vini këtu, sepse shkresat tuaja kalojnë nga Komisioni i Ligjeve dhe nga Shërbimi Juridik, i cili më këshillon: “Zonja kryetare e Komisionit të Medies bëni kujdes, mos shkëlmi ligjet e shtetit shqiptar, mos shkëlmi Kushtetutën, mos shkëlmi Rregulloren e parlamentit” dhe unë këtë po bëj, zotëri, dhe nuk është faji im. Kërkoni ndjesë se keni bërë gabim dhe i keni dhënë një draft të gabuar këtij Kuvendi, shkoni ndreqini draftin dhe unë jam përsëri këtu.

Zotëri, ju më keni marrë kohë me pa të drejtë dhe kam për detyrë t'ju akuzoj që më keni harxhuar kohën kot, duke lexuar dhe duke studiuar një draft të pasaktë. Pse keni ardhur me një draft të pasaktë, zoti Beqiraj?

Po, zoti Koçi.

**Ismet Beqiraj** – Jo të lutem, se pati një akuzë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ju lutem, zonja kryetare, letrat i keni, filloni procedurën.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Edhe ju drejtojeni komisionin sipas Rregullores.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ju lutem, filloni shqyrtimin...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Në fund të fundit atë detyrë keni, që të punojmë sipas ligjit me ndërgjegje dhe në mënyrë të saktë dhe jo me bindje politike.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ja ku është gabimi juaj...

**Flutura Açka** – Unë nuk kam asnjë gabim, pranoni gabimet tuaja.

**Ismet Beqiraj** – Ju lutem, filloni shqyrtimin e projektligjit.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ju nuk mund të nxirrni dot përfundime pa bërë shqyrtimin e projektligjit dhe nuk i jepni dot asnjërit fjalën që nga neni 1 të shkoni te neni 6.

Sigurisht, nuk është hera e parë në praktikën e veprimtarisë së komisioneve që diskutohet dhe kur është nevoja që nene të caktuara kërkojnë edhe konsulencën, edhe deklarin zyrtar nga ministri të ndryshme, që për këtë nen duhet ky mendim, stopohet, por jo direkt që sa të ma jepni mua fjalën si nismëtar, ia jepni asaj për procedurë, që shiko neni 6 i kësaj...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Le ta marrë fjalën njëqind herë për procedurë, se nuk e kam problem, por jo për nenet që janë propozuar. Sa për atë që të njoftohet Ministria e Financave, mos ia kërko nismëtarit, por kërkoja kryesisë, komisionit dhe vetes suaj.

**Flutura Açka** – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Fjalën e ka zoti Koçi.

**Petro Koçi** – Faleminderit!

Këtu u ngritën dy çështje me natyrë procedurale.

E para, ne shqyrtojmë draftin që ka ardhur zyrtarisht. Çdo komision ka të drejtë që gjatë shqyrtimit të bëjë ndryshime, të bëjë rregullime, siç ndodh kudo dhe siç është e gjithë përvoja parlamentare.

Për sa u përket efekteve financiare shqetësimi është plotësisht i drejtë, por ky komision ka avantazhin që propozuesit e projektligjit i ka anëtarë të tij. Atëherë, unë propozoj që këto nene që kanë efekte financiare të mos kalojnë, pra të kalojë e gjithë pjesa tjetër e projektligjit. E vetmja hapësirë mund të ishte që para kalimit në tërësi, mund të prisnim një mendim, nëse do të ketë kohë, përndryshe ligji do të kalojë pa ato nene që do të kenë efekte financiare. Pra, njëri që është për pagat dhe tjetri që është për trashëgiminë e fondeve të projekteve. Domethënë, ideja ka qenë gjithmonë për tri projektet kombëtare, me idenë që ato të mos ndërpriten.

Gjithsesi, janë të drejta edhe mendimet e Shërbimit të Monitorimit dhe të Komisionit të Ligjeve, ku unë kam qenë për diskutim, që duke pasur efekte financiare qoftë shtesë, qoftë

pakësim, është detyruar Kuvendi t'i kërkojë mendim paraprak qeverisë, Ministrisë së Financave. Meqenëse kjo nuk është bërë dhe debatet kanë mbetur pak a shumë në diskutim dhe me natyrë informale, atëherë komisioni nuk mund t'i aprovojë këto dy nene apo më shumë, por ne mund të vazhdojmë me pjesën tjetër të projektligjit.

Faleminderit!

**Flutura Aça** – Faleminderit, zoti Koçi!

Problemi qëndron se ne kemi një praktikë, flas për ligjin e dekriminalizimit, që e kemi diskutuar dhe, të jemi të sinqertë, e kemi harruar, do të na duhet ta diskutojmë nga e para. Edhe ligjin e trashëgimisë kulturore me zonjën Zhupa e kemi diskutuar dhe na ka mbetur pa u votuar dhe tani do ta bëjmë nga e para, pasi nuk e mbajmë mend fare se çfarë kemi diskutuar. Kështu, për mendimin tim, e mira është, nëse mund të bëhet shpejt nga Ministria e Financave, sepse nuk e di sa kohë mund të dojë, ne ta marrim në tërësi, të gjithën dhe ta mbarojmë brenda ditës atë që kemi për të bërë. Nëse e bëjmë me copa, ashtu do të na mbesë me copa, rrugës dhe nuk është mirë dhe as serioze as për ju, as për ne. Unë them që më mirë ta shtyjmë për një ditë tjetër dhe t'i dërgohet që sot shkresë Ministrisë së Financave...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Problemi është se çfarë do të bëhet me Ministrinë e Financave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Beqiraj, ne do ta shtyjmë për një ditë tjetër, të gjejmë një ditë të përshtatshme, edhe nesër po të doni, unë jam e gatshme që të mos thoni pastaj se po e shtyj për arsyet e mia, ndaj jam e gatshme që nesër. Unë e bëj publike votën time dhe nuk kam asnjë problem fare, nuk kam asnjë lloj kompleksi, ju mund ta diskutoni sa të doni, unë flas për votën time personale dhe jam edhe më e bindur për atë që kisha në mendje, sidomos pas seancës me zotin Fuga, por problemi është se ne nuk mund të vazhdojmë në këtë gjendje që është. Pra, ose rregullojeni te ligjet dhe pastaj është e rregulluar, keni çuar një draft tjetër dhe ne flasim për një draft tjetër dhe është e qartë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ky relacion ka ardhur kështu dhe këtu më kërkohet që të ftoj Ministrinë e Financave dhe unë jam e detyruar të respektoj ligjin, ky është ligji.

Zonja Zhupa e ka fjalën dhe më pas zoti Ndreca dhe zoti Beqiraj.

**Ina Zhupa** – Në cilësinë e relatores, unë kam një draft, i cili është depozituar nga zotërinjtë Beqiraj dhe Koçi. Gjithashtu, kam edhe një raport të Komisionit të Ligjeve, kam edhe Rregulloren,



kam edhe Kushtetutën. Në rast se zotërinjtë duan të ndryshojnë draftin e tyre dhe të sjellin një projektligj tjetër, të heqin apo të shtojnë nene, le të marrin kohën e tyre dhe më pas ta depozitojnë dhe ne të mund të relatojmë në bazë të këtij ligji. Në rast se zotërinjtë, po ashtu, duan të mbajnë të njëjtin draft, atëherë ne le t'u dërgojmë shkresë Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Financave, që të na sjellin efektin financiar dhe mendimin e tyre. Këto janë të vetmet opsione dhe nuk ka opsione të tjera, por që të krijohet një ligj i ri aty për aty me gojë, duke thënë heqim këtë apo shtojmë atë, ne nuk jemi në një recetë gatimi, shtojmë ujë e shtojmë miell, sepse edhe recetat duhen zbatuar siç duhet, që të dalë një ushqim i mirë, jo më një projektligj.

Nuk e kuptoj se çfarë nxitimi keni, çfarë sikleti keni që duhet të kalojë patjetër sot?! Sot u bë dëgjesa. Shumë mirë! Ne jua thamë si e kërkon Rregullorja dhe Kushtetuta, ju keni të gjithë votat për ta kaluar, Këshillin e Ministrave nuk besoj se do ta keni kundër, sepse nuk ka kuptim, se po të jetë qeveria kundër, nuk ju kalon as projektligji. Çojeni në Këshillin e Ministrave, merrni dakordësinë dhe sugjerimet nga Ministria e Financave dhe silleni përsëri. Unë nuk e kuptoj se ku është problemi?! Ne nuk kemi asnjë votë kundër që t'jua rrezojmë. Ju do ta kaloni këtë projektligj, ndaj çfarë problemi keni?! Tani, ne duhet të zbatojmë Rregulloren dhe Kushtetutën, sepse ato janë të vetmet që ne nuk i hedhim dot në votë. Kështu, ju lutem, në qoftë se doni që t'i hiqni ato nene hiqini, depozitoni ligjin e ri, siç doni ju që ta bëjmë, dhe ejani ta shqyrtojmë. Në qoftë se doni ta lini kështu, dërgojani Këshillit të Ministrave dhe silleni përsëri. Ndryshe kjo gjë nuk mund të bëhet dhe, sinqerisht, nuk ka arsye pse duhet të jetë ky nxitim. A mund të ma shpjegoni pse është gjithë ky nxitim, pse duhet ta bëjmë sot?! Më thoni një arsytim...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Po, zoti Ndreca dhe, më pas, zoti Beqiraj.

**Eduard Ndreca** – Faleminderit kryetare!

E para, mendoj se çështja e ndryshimit brenda ligjit është një problem dhe nuk duhet të na marrë kaq shumë kohë, pasi me të drejtë e thanë edhe zoti Koçi, edhe zoti Beqiraj, por edhe ne të gjithë e dimë që ligjin mund ta ndryshojmë këtu. Ne mund të rrezojmë nene dhe mund të ndërtojmë nene të reja, por shqetësimi im është se unë kam qenë relator te Komisioni i Ligjeve dhe kam lënë si porosi që t'i dërgohet një shkresë Ministrisë së Financave që të japë një përgjigje në lidhje me këtë projektligj dhe me ato nene që janë të lidhura drejtpërdrejtë me ministrinë përkatëse.

E dyta, në kontaktet që pata me relatoren, zonjën Gjylameti, ajo më kërkoi ta lexoj unë këtë memon dhe në fund të memos zonja Gjylameti kërkon që para se ligji të kalojë, duhet të kërkohet

mendimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, përveç Ministrisë së Financave. Pra, nëse Ministria e Arsimit dhe Sportit është ministria që harton ligjin për Akademinë e Shkencave, ndryshimi i këtij ligji, patjetër kërkon edhe një mendim prej saj. Tani, si do të operojmë ne, këtë e dini ju, por, në fakt, unë kur kam qenë relator te Komisioni i Ligjeve, kam ndarë mendime të ndryshme, të cilat atje më janë rrëzuar. Unë patjetër i besoj votës në shumicë, por kam qenë skeptik lidhur me mandatin, kam qenë skeptik në lidhje me heqjen e kufizimit për numrin e anëtarëve të brendshëm e të jashtëm, si dhe kam qenë skeptik edhe për këto ndryshimet që kemi bërë për moshën 75 vjeç, ku madje kam bërë edhe propozimet e mia në lidhje me këto tre probleme, sepse i kam konsideruar të nevojshme për të ndërhyrë. Unë u besoj dhe kam konsideratën maksimale për të dy hartuesit e ligjit dhe jam i bindur se drafti është një rregullim i nevojshëm për ligjin e Akademisë së Shkencave, por, para se të kalojmë te financat, është shumë e nevojshme që ne t'i vjelim një mendim Ministrisë së Arsimit, si institucioni përgjegjës në kuptimin e plotë të fjalës, pasi është Ministria e Arsimit ajo që harton ligjin për Akademinë e Shkencave. Më pas, a mund të kalojmë dhe t'i diskutojmë sot, kjo është një çështje që mund ta vendosim këtu, të diskutojmë, të relatojmë e t'i lemë përgjigjet e këtyre ministrive për në fund. Çështjen se si e zgjidhni, e dini ju, por unë mendoj se kjo gjë është shumë e nevojshme, edhe pas diskutimit që pata me relatoren e këtij ligji.

Faleminderit!

**Flutura Aça** – Zoti Ndreca, faleminderit!

Unë i lexova sugjerimet tuaja dhe dua t'ju komplimentoj. Ne do t'i diskutojmë edhe gjatë diskutimit të projektligjit, në mënyrë që edhe vetë të jemi më të qetë, se i kemi bërë mirë detyrat tona të shtëpisë.

Po, zoti Beqiraj.

**Ismet Beqiraj** – Zonja kryetare, si unë, ashtu edhe zoti Koçi, nuk kemi asnjë nxitim dhe duhet ta kemi të qartë këtë gjë. Pra, nuk kemi asnjë nxitim as personalisht dhe as politikisht.

Ne nuk e nxitëm këtë procedurë, por janë gjëra që tek e fundit nuk prekin bazën juridike dhe strukturore të të gjithë arkitekturës së këtij ligji. Për sa u përket rregullimeve për ato pika që kërkojnë debat, patjetër që nëpërmjet debateve dhe diskutimeve ne si nismëtarë menduam të paraqisnim këtë alternativë. A ka mendime të tjera? Sigurisht, çdo mendim racional do të integrohet. Pra, nuk është se janë definitive idetë që ne kemi, sepse gabimisht diku këtu janë bërë edhe disa lapsuse matematikore, për shembull, nuk është pika 9, por pika 10. Ky nuk është një faj

që, ejani ta gjykojmë dhe ta pushkatojmë nismëtarin, sepse kur ka reflektime, këto gjëra nuk duhet të diskutohen fare.

Unë i qëndroj edhe asaj që thanë zoti Koçi dhe zoti Ndreca, që nuk është hera e parë që ne ndeshemi me procedura të tilla, kur shqyrtojmë një projektligj. Pra, hapet diskutimi në parim i një projektligji, më pas e shqyrtojmë nën për nën dhe atje ku duhet, sigurisht, ne do të ndalemi. Edhe kur është bërë ligji bazë, në korrik të vitit 2019, ne kemi qëndruar me ditë të tëra në komision, duke e shqyrtuar, paradite dhe pasdite dhe nuk ishte e lehtë. Unë e kam thënë që edhe për tre apo katër ndryshime që mund të bëhen, ka një ndjesi të madhe publike dhe nuk e diskutoj këtë punë.

Kjo nuk është një praktikë që bëhet për herë të parë dhe, sigurisht, komisioni do të fillojë punën me një dokument parlamentar të depozituar dhe pastaj se çfarë rregullimi kam bërë unë vetë së bashku me gjithë kolegun tim, duke reflektuar edhe në bazë të relacionit të Komisionit të Ligjeve dhe mendimeve të akademikëve, këto pak rëndësi kanë. Këto do të pasqyrohen te miratimi nën për nën dhe në tërësi në finale, por nuk është në praktikë kjo që po bëjmë sot, që të bllokojmë hapjen e këtij diskutimi në parim. Ne mund t'i diskutojmë ato nene që nuk kanë të bëjnë me rregullime teknike dhe të heqim dispozitat parazite. Për shembull, në një nen janë dy dispozita parazite për mënyrën se si duhet të zgjidhen dhe bie fjala duhet të hidhen në votim dhe unë jam dakord që të hidhen në votim. Ne jemi mbledhur sot këtu pasi ju vetë e miratuat në kalendar këtë procedurë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Ligjeve ka kohë, me sa di unë që në datën 19 qershor, që ka zhvilluar mbledhjen, ndërkohë që juve ju ka ardhur raporti i këtij komisioni dhe ju keni caktuar edhe relatorët.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, mos ndërhyini, vajzë!

Te përfundimet e Komisionit të Ligjeve thuhet se duhet të merrni një mendim nga ministria. Ju duhet ta kishit marrë mendimin, sepse ju si kryesuese e seancës e keni këtë përgjegjësi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po merreni mendimin nga ministria...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Te relacioni?!

Relacioni i Komisionit të Ligjeve thotë që ju duhet të merrni mendim nga ky dhe nga ky. Zonja Gjylameti thotë se duhet merret edhe mendimi i Ministrisë së Arsimit. Pse unë që jam nismëtar duhet ta bëj këtë gjë?!

**Flutura Aça** – Zoti Beqiraj, u morëm vesh dhe mos na fajësoni për gjëra që nuk kemi faj. Unë e shpjegova dhe ne e kemi bërë një herë këtë debat. Unë ju kërkoj ndjesë për tonin e zërit. Ne nuk njihemi shumë bashkë, por me zotën Koçi njihemi para politikës, pasi kemi qenë miq edhe kur nuk kishim lidhje me politikën. Unë edhe kam stimë të jashtëzakonshme dhe po të jetë për zotën Koçi, unë e votoj që sot çdo ligj që mund të sjellë ai, pasi jam e bindur se ai është njeri me zemër dhe korrekt në të gjitha gjërat.

Zoti Beqiraj, kjo gjë është e vërtetë dhe unë nuk kam pse të luaj me të. Nuk e kam bërë unë këtë të vërtetë që është këtu, ndaj kur ta rregulloni këtë të vërtetë, atëherë do të flasim bashkë. Nëse vini këtu pa përfaqësuesit dhe pa shkresat e dy ministrive, aq më tepër të Ministrisë së Arsimit, ne nuk mund të vazhdojmë dot, zotëri. Ju keni sjellë këtu një draft tjetër dhe unë jam e papërgatitur për këtë draft. Ju vini këtu dhe thoni se keni një draft tjetër, ndërkohë që një komision ka punuar me tjetër draft, aq më tepër kur duhet edhe ndërhyrja e dy ministrive, ndaj nuk mund të vazhdojmë dot. Sot, brenda orarit zyrtar, do t'u dërgohen shkresat ministrive dhe mbledhjen e vendosim për ta zhvilluar në një moment të dytë...

**Ismet Beqiraj** – A mund të them vetëm një fjalë dhe nuk do të flas më pastaj?

**Flutura Aça** – Nuk është faji im, ndaj mos më vini faj mua.

**Ismet Beqiraj** – Ju lutem, a mund të them një fjalë dhe nuk do të flas më, në mënyrë që të ndihmoj çështjen?

**Flutura Aça** – Ju mund të flisni pafundësisht, se keni të drejtën tuaj, por, ju lutem, flisni me argumente, jo me emocione.

**Ismet Beqiraj** – Zonja kryetare, edhe ju kolegë të tjerë, nuk duhet të keqpërdoret sinqeriteti im, kur thashë se gjatë shqyrtimit nen për nen unë, bashkë me zotën Koçi, duke reflektuar nga ajo që është diskutuar në komision, do të japim mendimet tona për rregullim. Çfarë thashë tjetër?!

**Flutura Aça** – Zoti Beqiraj, nga respekti që kam për ju kërkoja ndjesë, ndaj mos e vini në dyshim respektin.

**Ismet Beqiraj** – Thjesht mos e keqpërdorni sinqeritetin, kur thashë se edhe ne, duke reflektuar nga të gjitha gjërat ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** – Fjalën e ka zonja Bano dhe, më pas, zoti Koçi.

**Eralda Bano** – Për procedurë.

Edhe një herë zonja kryetare: gjatë diskutimeve që u bënë këtu, edhe nga deputetë të mazhorancës, u ngrit një shqetësim i duhur, sidomos nga kolegët që janë pjesë e Komisionit të Ligjeve, ku kanë reflektuar dhe kanë kërkuar që të shprehet edhe Ministria e Arsimit për këtë çështje, përveç Ministrisë së Financave dhe relatorëve. Kështu, unë gjykoj, edhe me mirëkuptimin e zotit Beqiraj, që ne ta shtyjme dhe ta kalojmë nën për nën në një datë që mund ta vendosim së bashku, pasi të na kthehet një përgjigje nga Ministria e Financave.

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** – Fjalën e ka zoti Koçi dhe, më pas, zonja Zhupa.

**Ismet Beqiraj** – Thjesht kam një fjalë dhe mbase mbyllet diskutimi këtu. Ju kërkoni me ngulm që të shtyhet mbledhja, apo jo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Personalisht unë e respektoj hierarkinë dhe ai që është në krye të komisionit tim, të japë vlerësimin dhe jam dakord.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Petro Koçi** – Unë e propozova një zgjidhje, por, gjithsesi, le të japim pak hapësirë.

E para, nuk është e nevojshme që Ministria e Arsimit të japë mendim, sepse problemi është te Ministria e Financave. Unë mendoj se këtë çështje mund ta zgjidhim nesër, në kuptimin që ne do të konsultohemi me Drejtorinë e Legjislacionit të Kuvendit. Pra, nëse ne si propozues do të heqim dorë nga ato dy nene që prekin financat, kjo rrugë zgjidhet. Në të kundërt, duhet patjetër të na vijë shkresa e ministrisë për t'u shprehur për ato dy nene, sepse janë vetëm dy nene që prekin anën financiare. Kështu që brenda ditës së nesërme kjo çështje do të marrë përgjigje dhe besoj se ditën e mërkurë ne do ta shqyrtojmë ligjin.

**Flutura Aça** – Faleminderit, zoti Koçi!

Fjalën e ka zonja Zhupa dhe më pas do ta mbyllim mbledhjen.

**Ina Zhupa** – Unë jam dakord me zotin Koçi.

Unë si relatore, duke iu bashkuar edhe mendimit të zonjës Gjylameti, kërkoj që komisioni t'i drejtohet me një shkresë, ku t'i kërkohet mendim Ministrisë së Arsimit, t'i dërgohet edhe projektligji, si ministria përgjegjëse që harton legjislacionin në lidhje me Akademinë e Shkencave. Ky është propozimi im dhe i zonjës Gjylameti. I lutem komisionit që t'ia dërgojë shkresën në emër të relatoreve.

Faleminderit!

**Flutura Aça** – Faleminderit, zonja Zhupa!

Atëherë, stafi të mbajë shënim dhe t’u dërgojë shkresë të dyja ministrive. Në momentin kur komisioni të marrë në shqyrtim projektligjin, duhet të jenë prezentë edhe përfaqësuesit e Akademisë së Shkencave, sepse e kanë trashur pak si shumë muhabetin me mospërfilljen e tyre ndaj këtij komisioni.

Faleminderit shumë dhe do të shihemi së shpejti!

**MBYLLET MBLEDHJA**